

1 E enjte, 23 janar 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Thaçi nuk është i pranishëm]

5 --- Seanca fillon në orën 09.09

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

7 Tavakoli, dëshironi që të merrni fjalën për sa i takon -- ju

8 lutem, paraqisni lëndën së pari.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Rexhep Selimit, dhe Jakup
12 Krasniqit [Sipas përkthimit]. Faleminderit, të nderuar
13 Gjykatës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni -- a
15 doni të thoni diçka sa i takon paaftësisë ose pamundësisë të
16 dëshmitarit tuaj për të qenë i pranishëm në sallën e gjyqit
17 sot?

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju lutem.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Së pari të
20 kalojmë në seancë të mbyllur.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

18 Ju lutem, silleni dëshmitarin në sallë.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Përpara sesa të vijë dëshmitari në

20 sallë, mbase do ishte mirë që të informoj sa i takon kohës që

21 më ka ngelur për sot për të bërë pyetje për këtë dëshmitar.

22 I nderuar Gjykatës, juve ngritën çështjen e kohës në fund

23 të seancës dje, dhe dua që t'ju ndihmoj lidhur me këtë.

24 Kolegia ime, znj. Tavakoli, që është përfaqësuesja e z. Thaçi,

1 fillimisht kishte kërkuar 45 minuta. Dhe këto 45 minutëshin na
2 e kanë dhënë. Ndërkohë që kolegu im që është përfaqësuesi i z.
3 Selimi, po ashtu ka kërkuar 45 minuta, na kanë dhënë 30 minuta
4 ne. Ndërkohë që ekipi i z. Krasniqi fillimisht kishte kërkuar
5 një orë e 50 [Sipas përkthimit] minuta dhe e ka informuar
6 Trupin Gjykses që do përdorë vetëm 30 minuta, dhe 45 minuta do
7 na i japë neve. Kjo do të thotë që Mbrojtja e Veselit ka dy
8 orë plus dhe ne nuk shkojmë përtej kohës që i kemi kërkuar
9 Trupit Gjykses.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 Sa i takon këtij dëshmitari, e thashë dhe më herët,
12 megjithatë, dua ta theksoj dhe një herë se nuk e di doni që të
13 vazhdoj në praninë e dëshmitarit?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të
15 vazhdoni.

16 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] E di që shqetësimet kryesore
17 tuajat kanë të bëjnë me dëshmitarin tjetër që po pret që të
18 japë dëshmi. Besoj se e mbani mend që fillimisht kur ka qenë
19 dëshmitar sipas rregullës 153, dhe sa i takon pyetjes së
20 Mbrojtjes aktualisht vetëm një ekip Mbrojtjeje ka planifikuar
21 që i duhen -- i duhet 15 minuta për të bërë pyetje për
22 dëshmitarin e radhës, kështu që ne jemi të sigurt që do
23 përfundojmë me dy dëshmitarët sot.

24 Z. PACE: [Përkthim] Do i bie shkurt.

25 Dua të them që nuk është e -- nuk ka asnjë lloj të drejtë

1 që një ekip i Mbrojtjes të mund të marrë kohën e ekipeve të
2 tjera të Mbrojtjes, sepse është e rëndësishme që të shikohet
3 në kuadrin e relevancës pyetjet që bëhen nga ekipet e
4 Mbrojtjes.

5 Ndërkohë që pyetjet që i janë bërë dëshmitarit dje kanë
6 qenë shumë të përsëritura dhe kanë qenë të përgjithshme dhe
7 jorelevante. Dhe për shembull, janë bërë pyetje të tilla se
8 çfarë mund të ndodhte për një viktimë në qoftë se bie nga
9 biçikleta apo në qoftë se rezultatet mund të ishin të ndryshme
10 në qoftë se do të bëhej një autopsi e dytë.

11 Kështu që pa diskutim që mund të bëhet shumë nga ekipi
12 përkatës për sa i takon efikasitetit dhe harmonizimit apo
13 relevancës së pyetjeve.

14 Sa i takon dëshmitarit të radhës pra, në qoftë se pyetjet
15 janë të kufizuara ose kanë shumë pak pyetje ekipet e
16 Mbrojtjes, kjo është një çështje tërësisht tjetër. Kjo nuk i
17 jep të drejtë Mbrojtjes së Veselit që të vazhdojë të bëjë
18 pyetje për këtë dëshmitar, por vlerësimi duhet të bëhet mbi
19 themelësinë dhe mbi relevancën dhe natyrën e pyetjeve që bën
20 Mbrojtja e z. Veseli. Faleminderit.

21 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ju lë ca
23 hapësirë sot, nuk do t'ju ndërpres. Nuk ju duhen dy orë e
24 gjysmë për këtë dëshmitar.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Jo, jo, nuk po them që më duhen dy

1 orë e gjysmë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë po ju
3 them që nuk ju nevojiten dy orë e gjysmë. Ju lutem, bëjini
4 relevante pyetjet, mos i përsërisni pyetjet në qoftë se i keni
5 bërë më herët sepse gjysmën e pyetjeve që i keni bërë mund t'i
6 lexojmë te raporti. Kështu që nuk është e -- nuk ka ndonjë
7 vlerë që të bëni pyetje dhe që të merrni informacion që jepet
8 në raportin e akt-ekspertizës së tij. Ju lutem, mos përsërisni
9 pyetjet dhe mos përsërisni informacionin të cilin ne e dimë.

10 Mund të vazhdoni.

11 DËSHMITARI: JOHN CLARK [Vijon]

12 Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan:

13 [Vazhdim]

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

15 PY. Mirëmëngjes, z. Clark. Do vazhdojmë aty ku e lamë dje.

16 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Z. Sekretar, ju lutem paraqisni
17 raportin e z. Clark që ka numrin provizor të provës 1991, dhe
18 përveç kësaj do ju kërkoja që të shikonim diagramën që ka bërë
19 z. Clark për personin e vdekur që po shohim. Domethënë faqja 7
20 në dokumentin e parë, ndërkohë që dokumenti i dytë ka numër
21 ERN 124715 deri në 124723, nga i cili unë dua faqen 718. Atë
22 faqe që përfundon me këtë numër, 718.

23 PY. Z. Clark, ndërkohë që paraqitet ky dokument, besoj se ju
24 kujtohet se dje e lamë diskutimin që po shikonim këtë raport
25 për këtë personin që ka vdekur dhe po shikonim diagramën e

1 krijuar prej jush ku po gjurmonim plagët e armëve të zjarrit.
2 Si pikë nisëse, z. Clark, ju keni vërejtur se si një propozim
3 ose sugjerim i përgjithshëm është e pazakontë që të
4 identifikohet një pikë hyrëse dhe një pikë dalje në të
5 njëjtën sipërfaqe të trupit. A është kjo e vërtetë?

6 PË. Po.

7 PY. A është ky rasti që identifikohet në faqen që përfundon
8 me 718, pra që identifikohet që kjo situatë ka ndodhur me këtë
9 trup, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Keni vërejtur në raportin tuaj që gjurmimi ka qenë shumë
12 i dyshueshëm. A mund të na e shpjegoni pak, sepse sipas
13 mendimit tuaj ndërkohë që mund të ekzistojnë alternativa të
14 tjera, mendimi juaj është që ky lloj gjurmimi është
15 ekstremisht i pazakontë?

16 PË. E thashë dhe më herët që është shumë e pazakontë që të
17 kemi një pikë hyrëse dhe dalje në të njëjtën sipërfaqe. Me
18 përjashtim të rasteve ku plumbi hyn në një sipërfaqe shumë të
19 cekët, thujse, domethënë pa e cekur fare kockën, pra duke
20 kaluar në lëkurë. Pra, sikurse mund ta shikoni këtë person, ky
21 është një person i cili qëndron në të djathtë dhe pasi është
22 gjuajtur me armë në kraharor, ai bie në tokë në të djathtë dhe
23 në atë pozicion mund të ndodhë që plumbat të kalojnë në një
24 sipërfaqe ose në një kënd shumë të cekët. Ky është i vetmi
25 shpjegim që kam për këtë.

1 Megjithatë, pra, në qoftë se një plumb kalon në
2 sipërfaqen e lëkurës, pra, ajo çfarë shkaktohet është që jo
3 vetëm që është një vrimë e rregullt ajo që shkaktohet, por nga
4 ana tjetër krijohet edhe një plagë e cila është si e zgjatur
5 si perimetër, gjë e cila nuk është përshkruar në këtë
6 dokument. Pra, në këtë rast ndoshta, domethënë, është pak e
7 pazakontë sikurse e thashë dhe më përpara që të kemi një
8 shpjegim.

9 PY. Po ju thatë që kjo nuk ishte -- nuk ishte shumë e zakonitë
10 pra, i cili nuk është një rast i cili mund të ndodhë
11 zakonisht?

12 PË. Po.

13 PY. A është e mundur që të jetë bërë një gabim sa i takon
14 skicimit të plagëve të këtij personi?

15 PË. Po, është e mundur. Megjithatë, është e vështirë që të
16 besohet që nuk do të ketë plagë të tjera. Pra kemi një plagë
17 tek pjesa e kraharorit dhe pesë tek pjesa e shpinës. Por,
18 është e vështirë që të thuhet ose që të mendohet që një pikë
19 hyrëse e plumbit nga pjesa e përparme e trupit të -- pra,
20 është -- nuk është e pranishme. Domethënë, e thashë dhe një
21 herë që është situatë e pazakontë.

22 PY. Çfarë do të thotë që ju nuk mund ta zgjidhni ose nuk
23 është se e shpjegoni dot me informacion që keni në raport këtë
24 lloj situatë, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Pra, në faqen 7 të raportit tuaj juve ju bëhet pyetje,
2 dhe në faqen 8, domethënë, ju bëhet pyetje në qoftë se personi
3 i vdekur ka pasur mavijosje apo jo. A ju kujtohet kjo pyetje?
4 PË. Po, u diskutua dje.

5 PY. Atëherë, sa i takon mavijosjes në raport me mavijosjen e
6 përgjithshme a mund të na thoni se si mund të shpjegohet kjo
7 situatë?

8 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtohet pyetja sepse u bë
9 gjerësisht dje. Edhe jo vetëm për një person u pyet
10 dëshmitari, po u pyet për pesë persona.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

12 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

13 PY. Le të kalojmë tek faqja 8. Tek pyetja 3 -- ju kërkoj
14 ndjesë. Atëherë kalojmë tek paragrafi i dytë në faqen 3, ku
15 juve trajtoni çështjen e mekanizimit që ka shkaktuar
16 mavijosjes dhe ju thoni në fund fare që:

17 "Sa i takon mavijosjes në shpinë, në gjymtyrë në qoftë se
18 do të ishte reale ose do të ishte e vërtetë, atëherë bëhet
19 fjalë për një traumë prej force dhe që ka të ngjarë që mund të
20 jetë shkaktuar nga gjuajtjet me grushta ose me shqelma ose nga
21 gjuajtjet e një objekti të rëndë."

22 A është e vërtetë kjo?

23 PË. Po.

24 PY. Pra, kjo është një shpjegim që ka të bëjë me mekanizmin e
25 mavijosjes, apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Tani duke e pasur parasysh këto elementë, a mund t'ju
3 pyes sa i takon mungesës së plumbave. Mungesa e plumbave në
4 këtë trup është diçka që ju e keni konstatuar po ashtu në këtë
5 pjesë të raportit dhe ju thoni që është mbresëlënëse ose e
6 befasuese që të shohësh që nuk ka të identifikuar prani të
7 plumbave.

8 Duke marrë parasysh numrin e plagëve nga të shtënat me
9 armë në këtë trup, a është e drejtë të thuhet që shqetësimi
10 juaj mbetet ende edhe tani?

11 PË. Po. Mendoj që komentet zbatohen për tërësinë e rasteve,
12 domethënë. Domethënë, të gjitha komentet e mia janë të vërteta
13 për pesë rastet që i kemi diskutuar, i diskutuam dhe dje në
14 hollësi dhe shqetësimet kanë të bëjnë me mungesën e plumbave.

15 PY. Në rregull. Pra, e di që ju i keni dhënë elementët
16 kryesore të komenteve tuaja sa i takon këtij personi të
17 vdekur, megjithatë, në raport me këtë person të vdekur, a do
18 ishte një përmbledhje e drejtë që thuhej që në raportin tuaj
19 thekson shqetësimet të cilat kanë të bëjnë me realitetin në
20 qoftë se kanë ndodhur këto mavijosje të synuara, saktësinë e
21 plumbave, gjithashtu, edhe mungesën e konstatimeve GSR, si dhe
22 mungesën e plumbave në vetvete? A është një përmbledhje e
23 saktë kjo e shqetësime kryesore që keni thënë juve dhe që keni
24 paraqitur ju në raport sa i takon këtij personi të vdekur?

25 PË. Po, të gjitha këto janë shqetësime të cilat unë i kam

1 ngritur në raportin tim.

2 PY. Përsëri raportit që pamë dje, në këto rrethana do ishte e
3 drejtë që të thuhet që sot ju nuk jeni në pozitë ose nuk jeni
4 -- nuk keni mundësi që të konstatoni gjetjet e këtij raporti
5 dhe të thoni që këto janë gjetjet e raportit tuaj? I referohem
6 këtu raportit të patologut?

7 PË. Po, kjo është e vërtetë.

8 PY. Tani duam të marrim pak më shumë informacion sa i takon
9 besueshmërisë dhe mbështetshmërisë së konstatimeve themelore.

10 PË. Po.

11 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Tani të shohim faqen 9.

12 PY. Të shikojmë, z. Clark, sa -- të shohim disa prej
13 elementëve që kanë të bëjnë me këtë person të vdekur.

14 PË. Në këtë rast plagët nga të shtënat me armë janë shumë të
15 drejtpërdrejta.

16 PY. Pra, gjurmimi nuk ka të bëjë me këtë viktimë konkretisht,
17 apo jo?

18 PË. Jo.

19 PY. Megjithatë, sa i takon shqetësimeve, sa i takon
20 mavijosjeve, shqetësimet tuaja lidhur me mavijosjen aplikohen
21 edhe ose janë të vërteta dhe në rastin e këtij personit të
22 vdekur apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Por diagrami në vetvete, ose diagrami që ju keni
25 përpiluar në vetvete nuk ngre shqetësime të cilat kanë të

1 bëjnë me plagët prej armëve të zjarrit të gjurmuara këtu, apo
2 jo?

3 PË. Po.

4 PY. Sa i takon pyetjeve shtesë, ju jeni pyetur lidhur me
5 mekanizmin për mavijosjen. Pra, jeni pyetur në pyetjen 3, në
6 faqen 10, se cili është mekanizmi i mavijosjes.

7 PË. Ashtu.

8 PY. A do ishte e vërtetë që të kuptohej që na keni dhënë këtu
9 mundësi për mekanizmin që ka shkaktuar mavijosjen, megjithatë,
10 lista nuk është shteruese lidhur me mundësitë që mund të kenë
11 çuar në mavijosje? A është kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Sigurisht në rrethanat që ne i kuptojmë që aplikohen.
14 Atëherë të kalojmë te faqja 4.

15 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Atëherë, shikoj që nuk është faqja
16 e duhur në ekran, kështu që do i kërkoja Sekretarit të kalojmë
17 te faqja 10.

18 PY. Juve ZPS-ja ju pyet që të komentoni, ashtu siç ju është
19 kërkuar gjithashtu që të jepni komentin tuaj lidhur me këtë
20 pyetje edhe gjatë në raport se cila ka qenë distanca e
21 personit që ka gjuajtur në drejtim të viktimës. Dhe -- pra,
22 ideja ka qenë që të shtënit me armë ka ndodhur nga distanca,
23 në distancë, apo jo? Është e saktë kjo, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. Megjithatë, "të shtënit në distancë" nuk është se ka

1 ndonjë domethënie shumë të madhe në fushën tuaj të

2 ekspertizës, apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Kur flasim për lëndime, për plagë me armë zjarri, ne kemi

4 tendencë që të identifikojmë distancën, për shembull, shohim

5 në qoftë se, për shembull, kur arma është menjëherë në kontakt

6 të drejtpërdrejtë me lëkurën ose në kontakt me shkurtër kur

7 është pak më larg, ose distanca tjetër është nga një metër ose

8 një metër e gjysëm. Pak a shumë këto janë parametrat e

9 distancës që ne identifikojmë. Ndërkohë që sa i takon

10 aspekteve patologjike në qoftë se të shtënit ka ndodhur përtej

11 distancës një metër e gjysmë, ne themi që distanca ka qenë e

12 largët. Pra, distanca në vetvete mund të jetë e ndryshme. Këtë

13 po përpiqem të shpjegoj.

14 PY. Megjithatë, besoj që nuk jeni në gjendje që ju të

15 identifikoni se çfarë do të thotë kjo që "të shtënit ka

16 ndodhur në distancë"?

17 PË. Po.

18 PY. Megjithatë, ne mund të prezumojmë që ndoshta patologu ka

19 nënkuptuar një distancë prej një metri, megjithatë nuk e themi

20 dot me siguri këtë gjë, apo jo, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Sa i takon këtij raporti, kësaj autopsie, a mund të bëjmë

23 këtë përmbledhje ne që ju keni qenë pak më të shqetësuar --

24 pak më të shqetësuar sesa në këtë raport krahasimisht me

25 raportet e tjera, megjithatë keni pasur shqetësime që

1 lidheshin kryesisht me mavijosjet dhe keni pasur dhe
2 shqetësime të përgjithshme, për shembull, për mungesën e
3 plumbave që është e vërtetë edhe në këtë rast, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Në këto rrethana, a do ishte e saktë që të thuhej që ju
6 nuk jeni në gjendje sot që të miratoni ose të pranoni
7 konstatimet e këtij raporti si konstatimet tuaja?

8 PË. Po.

9 PY. A ndodh kjo sepse ju nuk jeni në pozitë që të merrni
10 informacion shtesë në mënyrë të tillë që të mund të vërtetoni
11 besueshmërinë apo saktësinë e konstatimeve të paraqitura në
12 raport?

13 PË. Po.

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Le të kalojmë në fund të faqe.
15 Atëherë do shikojmë raportin tjetër dhe do shohim faqen 10.

16 PY. Z. Clark, ky është njëri prej trupave ku ju keni ngritur
17 shqetësime më të mëdha në veçanti sa i takon trajektore të
18 plumbit. Është e saktë kjo?

19 PË. Po. Këtu ka kryesisht dy shqetësime kryesore.

20 PY. Do ju ndaloj këtu. Ndoshta do të ishte më mirë që të
21 paraqesim dhe diagramin, sepse mund t'ju ndihmonte që të jepni
22 shpjegimet tuaja më saktë.

23 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit për këtë
24 arsye që të japë dokumentin me ERN 1234715 deri në 124723,
25 faqja 720. Do ju lutesha që ta paraqisnit këtë faqe. Ju lutem

1 shohim edhe komentet në fund. Duhet dhe koka e diagramës, aq

2 sa të mundemi, ju lutem. Faleminderit.

3 PY. Z. Clark, është e mjaftueshme për ju?

4 PË. Po.

5 PY. Me ndihmën e kësaj diagramës, a mund të na shpjegoni

6 trajektoren për këtë person?

7 PË. Ky burri ka gjashtë plagë me armë zjarri. Ka mundur edhe
8 më shumë. Pikëpyetjet që kam unë për këtë është se në një prej
9 tyre është një plagë në kokë edhe pika hyrëse është në pjesën
10 e djathtë të ballit, diku mes për mes të ballit, dhe ka dalë
11 shumë afër. I ka dalë se është po ashtu shumë afër. Është e
12 pazakontë edhe kjo. Edhe është një plagë poshtë veshit të
13 majtë që është vënë në dukje, po nuk është dhënë asnjë
14 përshkrim në tekst.

15 Sërisht, ju thashë, ndodh ka dhe armë, ka dhe plagë nga
16 armët e zjarrit që janë të cekëta. Po nuk ka një shtjellim pse
17 për këtë situatë të pazakontë.

18 PË. Flasim fillimisht për plagën në armën e zjarrit. Pika
19 hyrëse dhe pika dalëse. Sipas jush, është shumë e pazakontë,
20 apo jo?

21 PË. Nuk është e pamundur, po do thoja që është e pazakontë.

22 PË. Kur bëhet një konstatim i tillë, sipas jush duhet të ketë
23 një shpjegim në raportin e autopsisë për shkak të natyrës së
24 pazakontë të kësaj plage?

25 PË. Po, kjo do ishte më normale. Gjithashtu një pikëpyetje

1 është, për shembull, në pjesën e përparme të trupit dhe që ka
2 dalë nga shpina janë disi më të drejtpërdrejta, po ka disa
3 plagë në pjesën e përparme të trupit, po unë do kisha
4 pikëpyetje për pikat dalëse, për shembull, për këtë dhe për
5 këtë. Sidoqoftë, nuk mendoj që është shumë e rëndësishme.

6 PY. Kur thoni ju nuk është e rëndësishme, ju thoni që
7 vartësisht gjurmëve të plagëve hyrëse dhe dalëse, nuk e
8 përcakton të qartë kjo shkakun e vdekjes?

9 PË. Po.

10 PY. Por, sipas jush, nëse këto gjetje janë të sakta, dhe janë
11 evidentuar siç duhet pikat hyrëse, pikat dalëse, kjo është
12 diçka që le pikëpyetje për ju?

13 PË. Është një rast i vështirë se ka disa plagë në trup dhe
14 është gjithmonë e vështirë që të gjesh kush është pika hyrëse
15 dhe kush pikë dalëse i përket. Personi që ka bërë këtë raport
16 ka dalë me gjetjet e vetja, unë mbase do kisha pasur gjetjet e
17 mia.

18 PY. Faleminderit.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] E heqim nga ekrani. Të nderuar
20 Gjykatës, këto tre diagramat do të doja që t'i paraqisja për
21 t'u pranuar si provë, dhe t'ju jepnim një numër provizor, ju
22 lutem.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, na jepni

1 numrat, ju lutem.

2 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po, patjetër. Është faqja 124720,
3 po ashtu faqja 124718 dhe 124717. Janë tre faqe.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
5 kundërshtim për pranimin e diagrameve?

6 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,
8 materiali që mban numrin 124720, 124718, 124717 marrin numër
9 provizor.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Këto tri
11 faqe do të marrin numrin provizor 2D0041 dhe klasifikimi është
12 konfidencial.

13 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit. Mund ta heqim
14 diagramën.

15 PY. Z. Clark, sa i takon këtij personit të vdekur, ju janë
16 bërë pyetje sa i takon mavijosjes edhe mbetjeve të barutit në
17 trupin e tij. Kështu?

18 PË. Po.

19 PY. A e kemi kuptuar ne drejtë që pikëpyetjet tuaja vlejné
20 edhe për këtë raport?

21 PË. Po.

22 PY. Edhe njësoj për faktin që mungon -- nuk ka gjetje për
23 plumbin dhe trajektoren e plumbit?

24 PË. Po.

25 PY. Atëherë, a mund të themi për këtë raport si përmbledhje

1 se ka dyshime sa i takon gjetjeve lidhur me mavijosjen, duhet
2 të shikohet edhe një herë me kujdes mbetja e barutit edhe ka
3 pikëpyetje sa i takon trajektoreve së plumbit dhe mungesës së
4 plumbave, saktë?

5 PË. Po.

6 PY. Pra, njësoj si me raportet e tjera, edhe për këtë raport,
7 ju nuk jeni në gjendje sot t'i miratoni tërësisht gjetjet në
8 të?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe kjo për arsye sepse juve nuk ju është dhënë
11 informacion mbështetës ç'ka do të thotë që ju nuk mund ta
12 konfirmoni saktësinë apo besueshmërinë e këtyre gjetjeve?

13 PË. E saktë, po.

14 PY. Mirë.

15 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shkojmë në faqen -- në grupin e
16 fundit të këtyre raporteve, ju lutem, dhe të shohim faqen 12
17 të raportit të fundit.

18 PY. Z. Clark, po përpigëm që të punojmë pak më shpejt sot
19 paradite. Por sidoqoftë nëse ju nevojitet kohë t'i lexoni
20 përgjigjet, ju lutem na e thoni.

21 Por, sa i takon këtij trupi, a mund të themi që
22 pikëpyetjet dhe dyshimet tuaja për mavijosjen vlejné njësoj si
23 për raportet e tjera?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe pikëpyetjet tuaja po ashtu për mbetjet e barutit,

1 sepse nuk keni pasur plumbat?

2 PË. Po.

3 PY. Nuk është qartë në ç' distancë ka qenë personi që ka
4 gjuajtur dhe për këtë -- dhe këtë e keni thënë në faqen 13,
5 pyetja 5.

6 PË. Po.

7 PY. Faleminderit. Tani duke marrë të gjitha këto parasysh, ju
8 nuk jeni në gjendje të miratoni tërësisht gjetjet dhe
9 konstatimet edhe për këtë raport?

10 PË. Po. Po unë nuk kam dyshime për trajektoren në këtë rast.
11 Por për t'ju përgjigjes pyetjes suaj --

12 PY. Mbase nuk u shpreha mirë. Nuk e shpreha unë këtë
13 shqetësim. Unë thashë, për ju pikëpyetjet ishin mavijosja,
14 mbetja e barutit, mungesa e plumbave.

15 PË. Po.

16 PY. Edhe njësoj si me rastet e tjera që ne pamë --

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
18 ngadalësoni.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

20 PY. Gjithsesi me rastet e tjera, edhe në këtë rast nuk ka
21 pasur shenja të mbetjes së barutit.

22 PË. Po.

23 PY. Që ta sqarojmë dhe një herë pyetje se nuk u pasqyrua në
24 procesverbal [E pakuptueshme]. Pra, sot ju nuk jeni në gjendje
25 të miratoni tërësisht gjetjet dhe përfundimet, apo jo?

1 PY. Dhe nuk mund ta bëni këtë sepse nuk keni pasur
2 informacion shtesë sa i takon saktësisë dhe besueshmërisë së
3 këtyre gjetjeve?

4 PË. Po.

5 PY. Para se të kalojmë tek metodologjia që është ndjekur në
6 këtë autopsi.

7 Duke qenë se ju nuk keni qenë i pranishëm kur është bërë
8 autopsia, a mund të themi që nuk jeni sot në pozita të
9 konfirmoni se metodologjia e ndjekur ka plotësuar standardet
10 që sipas jush janë standardet që duhen zbatuar në raste të
11 tilla ose që sipas jush duhen zbatuar?

12 PË. Po, unë nuk e di si janë kryer autopsitë, në ç'kushte
13 janë kryer, çfarë ndihme është ofruar, pra nuk mund të
14 komentoj në lidhje me këtë.

15 PY. Dhe ne e dimë aktualisht që në atë kohë nuk ka pasur
16 përfshirje ndërkombëtare apo të UNMIK-ut kështu që nuk mund të
17 flasim tani për standardet e kësaj autopsie, a ka qenë të
18 besueshme, apo jo?

19 PË. Jo.

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shkojmë në faqen 16, ju lutem.

21 PY. z. Clark, do shihni në krye të faqes për cilin person të
22 vdekur do flasim.

23 Z. Clark, a është e vërtetë që ky person i vdekur për të
24 cilin u bë -- është bërë autopsia, për këtë person ka qenë
25 vetëm mbetjet skeletore?

1 PË. Po.

2 PY. Diskutuar dje se sa kufizime ka të kryesh një autopsi mbi
3 mbetje skeletore.

4 PË. Po.

5 PY. Në pjesën e paketës së materialeve që morët për këtë
6 person të vdekur, a është e vërtetë që keni marrë një akt-
7 ekspertizë që është përgatitur nga një ekip prej katër
8 ekspertësh?

9 PË. Po, ka qenë një raport përmbledhës.

10 PY. Po, po, ka qenë një raport përmbledhës. Ah po, ka qenë
11 katër ekspertë. Ju thonë gjë këta emra? Asnjë nuk -- nuk e
12 shqiptova saktë në fakt.

13 PË. Raporti përmbledhës, me sa kuptoj unë, është përgatitur
14 nga Dr. Dunjic.

15 PY. Dhe si pjesë e materialeve, po, keni marrë një raport
16 përmbledhës, por keni marrë edhe një raport të katër
17 ekspertëve. Keni marrë dy dokumente në paketën e materialeve.

18 PË. Po.

19 PY. Pra, që të jemi të qartë, një e kishte bërë Donjic,
20 patologu, një e ishte një raport përmbledhës prej tij, nga një
21 patolog tjetër dhe nga një antropolog tjetër.

22 PË. Ky raporti i kombinuar është shkuar në kohën e autopsisë.
23 Ndërsa raporti i konsoliduar, përmbledhës është shkuar rreth
24 nëntë vjet më pas.

25 PY. Mirë. Shohim përmbledhjen tuaj lidhur me këtë raport. Do

Dëshmitari: John Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan (Vazhdim)

Faqe 21

1 përdorim dokument që kemi përpara se është më e thjeshtë ta
2 përdorim si referencë. A mund të themi se ata kanë thënë "në
3 mungesë të indeve të buta", sipas tyre "nuk mund të
4 përcaktohej shkaku i vdekjes". A kanë thënë kështu?
5 PË. Formulimi ka qenë i tillë, duke qenë se trupi ka qenë i
6 dekompozuar, nuk mund të përcaktohej shkaku i vdekjes. Por nuk
7 është folur për lëndimet dhe është thënë se për shkak të
8 dekompozimit, të shkallës së dekompozimit të trupit, nuk mund
9 të përcaktohej shkaku i vdekjes. Po unë jam habitur se si kanë
10 dalë në këtë përfundim.

11 PY. Në raportin tuaj, në faqen 17, në paragrafin 4, ta keni
12 si referencë.

13 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po sidoqoftë le ta vendosim dhe në
14 ekran.

15 Z. PACE: [Përkthim] Më lejoni t'ju ndërpres, ju lutem, i
16 lutem avokates në faqen 21, rreshti 14, a mund ta sqarojmë me
17 dëshmitarin çfarë tha, se mendojmë se nuk ka dalë katër në
18 procesverbal.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk e kuptova çfarë problemi.

20 Z. PACE: [Përkthim] Në faqen 21, rreshti 14, dëshmitari
21 sipas transkriptit ka thënë:

22 "Dhe kjo është ngritur për çdo lëndim".

23 Është pak e paqartë. A mund ta sqaroni çfarë është dashur
24 të thuhet me këtë fjali.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

1 PY. Z. Clark, përgjigja juaj:

2 "Dhe kjo është shprehur përpara se të flitet për lëndimet
3 ..."

4 PË. Po, duhet të them "mbi -- përpara, më falni", "përpara se
5 të flitej për lëndimet".

6 PY. Faleminderit. Vazhdojmë tani me raportin dhe shohim
7 paragrafin e katër në faqen 17. Ju vini re që patologu nuk ka
8 qenë i sigurt kur ka dalë në përfundimet e veta kur ka thënë
9 që:

10 "Gjurma e plumbit që ka kaluar nga kafka të ketë qenë
11 shkaku për vdekjen sepse nuk ka pasur inde të buta dhe nuk ka
12 pasur as truri -- as truri nuk ka qenë aty për të përcaktuar
13 gjurmimin. Prandaj ka qenë e pamundur në këto kushte të
14 përcaktohej nëse plumbi ka qenë shkaku i vdekjes, për shkak se
15 edhe dëmtimi fizik i eshtrave duket i ngjashëm nëse do të
16 kryhej dhe ditët pas vdekjes."

17 A është ky një përshkrim i saktë?

18 PË. Po.

19 PY. Fokusohemi tek patologu Dr. Donjic. Sipas jush, qasja e
20 tij, përfundimi i tij a është një përfundim që do ta kishin
21 nxjerrë dhe shumë patologë të tjerë?

22 PË. Po.

23 PY. Sidoqoftë për ju nuk është një konkluzion i dobishëm por
24 shumë patologë në këtë konkluzion do të dilnin?

25 PË. Unë mendoj që numër i vogël patologësh do kishin dalë në

- 1 këtë lloj përfundimi besoj. Unë kuptoj pse ka hezituuar
2 dokumenti që të përcaktojë shkakun e vdekjes, por do kishte
3 qenë e dobishme të shpjegohej pse. Të shpjegohej qasja që
4 është ndjekur, pse kanë hezituuar. Edhe nuk shprehet
5 absolutisht as në këtë raport, as në raportin përmbledhës
6 qoftë sado pak nuk trajtohet kjo çështje.
- 7 PY. Pra, nuk ja u shpjegojnë lexuesit për çfarë arsye kanë
8 dalë në atë përfundim që nuk mund të përcaktohet shkakun i
9 vdekjes dhe në çfarë rrethanash dolën në këtë përfundim?
- 10 PË. Po.
- 11 PY. Por ju në raportin tuaj thoni që mund të dilet dhe mund
12 të jepet dhe ky opinion?
- 13 PË. Po.
- 14 PY. Shohim tani duke marrë parasysh këto që kemi diskutuar
15 deri tani, ju thoni që mund të dilet, pra, në një përfundim të
16 tillë, nuk është një konkluzion që sipas jush do të ishte i
17 palogjikshëm?
- 18 PË. Jo, nuk është i palogjikshëm, është i kuptueshëm. Por nuk
19 është i dobishëm.
- 20 PY. Po. Por duke mos qenë i dobishëm, ju nuk do të thoni
21 vetë që është i pasaktë ose i gabuar dhe është pa asnjë bazë
22 shkencore?
- 23 PË. Jo. Por patologu nuk mund të ofrojë -- mendoj që patologu
24 duhet të ofronte një shpjegim dhe një pikëpamje të vetën për
25 këtë.

1 PY. Dhe kjo nuk është bërë në këtë rast?

2 PË. Jo.

3 PY. Sa i takon gjetjeve të këtij raporti, ju personalisht do
4 të kishit ndjekur një qasje tjetër, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe në ndryshim nga ky ekip që ka ekzaminuar mbetjet
7 fillimisht, ju personalisht do ta kishit dhënë shkakun e
8 vdekjes në këto rrethana, apo jo?

9 PË. Unë po. Do kisha dhënë dhe shpjegimin pse do ta bëja
10 këtë.

11 PY. Dhe sipas jush, mund ta përcaktoni shkakun e vdekjes deri
12 në një shkallë të arsyeshme probabiliteti?

13 PË. Po.

14 PY. Pra, kjo që kemi këtu, a kemi dy drejtime të ndryshme nga
15 persona të së njëjtës fushë, sa i takon ekzaminimit të
16 mbetjeve skeletore në këto rrethana?

17 PË. Po, dhe është interesante se në raportin përmbledhës të
18 shkruar pas nëntë vitesh, Dr. Dunjic, në shumë raste, në fakt,
19 pothuajse e pranon një pikëpamje tjetër, një pikëpamje të
20 ndryshme.

21 PY. Po jo për këtë të vdekur?

22 PË. Jo, në fakt, jo për këtë rast konkret.

23 PY. Pra kemi dy pikëpamje të ndryshme profesionale --
24 profesioniste nga ekspertët, lidhur me qasjen e ndjekur dhe që
25 sipas jush të dyja janë të vlefshme?

1 PË. Po.

2 PY. Flasim për fraksionet, ju lutem, të çarat. Të çarat janë
3 shënuar edhe -- fraksionet janë shënuar dhe për këtë trup, apo
4 jo?

5 PË. Po. Sidomos për gjurmët e armëve të zjarrit.

6 PY. Shohim faqen 18 të raportit tuaj ku flitet për këtë. A
7 është e vërtetë që në këtë rast mungonin -- në këtë skelet
8 mungonin disa eshtra?

9 PË. Po. Edhe mungonin edhe pjesë e eshtrave që ishin të
10 thyera.

11 PY. Pra, edhe eshtrat ku u vunë re fraksionet, thyerje, nuk
12 ishin të plota, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Patologu që ka ekzaminuar këto eshtra ka komentuar që
15 thyerjet e eshtrave nuk ishin për shkak të armëve të -- armës
16 së zjarrit, por shkak të një rrëzimi. Pra, ai përjashtoi
17 mekanizmat e mundshëm dhe nuk përfshiu mekanizmat e mundshëm.

18 PË. Saktësisht, po.

19 PY. Pra, ju do të kishit ndjekur një qasje mbase disi më të
20 ndryshme. Lidhur me këtë do të kishit bërë gjetje më
21 gjithëpërfshirëse sa i takon këtyre eshtrave, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Pra, edhe në këtë rast kemi dy ekspertë të fushës që
24 shohin të njëjtat eshtra dhe mund dilnin në përfundime të
25 ndryshme, apo jo?

1 PË. Sipas meje, nëse mungojnë pjesë të eshtrave, nuk mund të
2 përjashtohet -- nuk mund të përjashtohet edhe plagosja me armë
3 zjarri. Po nëse mungon një pjesë e eshtrave, nuk mund ta
4 përjashtosh sidoqoftë faktin që mund të ketë ndodhur diçka për
5 shkak të armës së zjarrit?

6 PY. Por jo sidoqoftë do të dilnit në përfundime të ndryshme
7 nga Dr. Dunjic?

8 PË. Po.

9 PY. Por ju nuk do ta përjashtonit atë si mundësi?

10 PË. Jo.

11 PY. Dhe ndryshe nga Dunjic, ju nuk do të përjashtonit
12 mundësinë e një mekanizmi për shkak -- për shkakun e dëmtimit
13 të eshtrave që mund të ketë qenë edhe trauma prej forcës?

14 PË. Po.

15 PY. Ai, në fakt, ka dashur të thotë që shkakun e vdekjes ka
16 qenë për shkak të traumës nga forca.

17 PË. Unë nuk [E pakuptueshme] specifikisht, po mendoj që
18 implikimi është ky.

19 PY. Por ju do të thonit sidoqoftë, në mënyrë jopërfundimtare
20 se cili është mekanizmi për këto lëndime?

21 PË. Po. Gjithashtu, duhet të themi që ajo që nuk diskutohet
22 këtu është infrastruktura *post mortem*. Dhe ajo që vihet re në
23 këtë raport që ka pasur fraksion, apo thyerje të shumë
24 eshtrave dhe nuk është diskutuar në asnjë pjesë të raportit që
25 këto thyerje mund të jenë shkaktuar edhe pas vdekjes kur është

1 zhvendosur trupit, kufoma. Dhe mendoj që kjo është një mundësi
2 shumë reale.

3 PY. A mund ta trajtojmë pak më gjerësisht këtë. Është e
4 vështirë me mbetje skeletore të përcaktohet nëse thyerja është
5 -- ka ndodhur para apo pas vdekjes?

6 PË. Po.

7 PY. Ose kohë pas vdekjes?

8 PË. Shumë kohë pas vdekjes është probabiliteti edhe më i
9 lartë. Janë fraksione *post mortem*.

10 PY. Dhe ky trup, kjo kufomë është gjetur me disa kufoma të
11 tjera dhe e keni diskutuar në raportin tuaj, në fakt, në shumë
12 raste kishte fraksione?

13 PË. Po, kishte fraksione shumë të mëdha në eshtra. Në femur
14 edhe në eshtrat e gjata.

15 PY. Kur thoni ju "fraksione madhore", do të thoni që ka pasur
16 një thyerje që është shumë -- që është një, një, një fraksion
17 që mund ta shkaktonte goditja nga një makinë, apo jo?

18 PË. Në fakt, që të thyesh femurin duhet shumë forcë. Nuk mund
19 t'ja thyesh dikujt femurin thjesht duke e shkelmuar. Po kjo
20 mund të ndodhë ose nga rënia nga një lartësi e lartë ose
21 goditja nga një automjet. Forca të këtij lloji.

22 PY. Pra, a mund të themi, shkallë e konsiderueshme force?

23 PË. Po, mund të jetë një lloj formulimi ky.

24 PY. Pra, për të shkaktuar këtë lloj lëndimi duhet një
25 automjet apo siç thatë ju më herët, një rënie nga një lartësi

Dëshmitari: John Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan (Vazhdim)

Faqe 28

1 e konsiderueshme?

2 PË. Po.

3 PY. A mund të themi për këtë trup, pavarësisht nëse
4 fraksionet -- ju do të thonit që nuk mund të përcaktohet nëse
5 fraksionet janë shkaktuar para apo pas vdekjes?

6 PË. Po.

7 PY. Pra, sipas jush, është edhe mundësia, ekziston edhe
8 mundësia që këto thyerje të eshtrave të ketë ndodhur edhe pas
9 vdekjes?

10 PË. Mendoj se është e mundshme, po.

11 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Shohim faqen 19, ju lutem, të
12 raportit tuaj. Ju lutem të zmadhohet pak.

13 PY. Z. Clark, këtu do shihni emrin e të vdekurit që do të
14 diskutojmë tani. Është në krye të faqe. Në krye të faqe, do të
15 shohim që autopsia është në 2004 nga Dr. Morcillo.

16 PË. Po.

17 PY. Shohim dhe përmbledhjen e gjetjeve në krye të raportit
18 tuaj. A është e vërtetë që z. -- Dr. Morcillo mendoj që ky
19 është një i vdekur për të cilin nuk mund të përcaktohet shkaku
20 i vdekjes?

21 PË. Dhe unë pajtohem me këtë gjetje?

22 PY. Pajtoheni me këtë gjetje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
24 ju lutem numëroni deri në katër përpara se të flisni ju. Ju
25 lutem, ju lutem. T'ju ndihmojë dhe kolegu me shpejtësinë. Më

1 vjen keq që po ju ndërpresim gjatë të gjithë kohës.

2 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Le të më ndërpresë kolegja
3 atëherë.

4 PY. Z. Clark, ju thatë që nuk i kundërshtoni gjetjet, dhe se
5 shkak i vdekjes për këtë person është i papërcaktuar?

6 PË. Po.

7 PY. Ajo që është gjetur në mbetjet skeletore po ashtu në këtë
8 rast ka qenë thyerje e eshtrave?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe ka qenë e qartë që një nga këto thyerje, apo këto
11 fraksione ka qenë në gropëzën e syrit edhe për këtë patologu
12 ka qenë i sigurt dhe e ka shprehur në raport?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
14 unë sapo ju ndalova, sapo ju këshillova. Prisni pak përpara se
15 të përgjigjet dëshmitari. Nuk i jepni mundësi të mbarojë -- të
16 mbarojë, të mbarojë fjalja. Nuk bëni asnjë pauzë.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

18 PY. Ka pasur tre fraksione të tjera të evidentuara edhe në
19 këtë kufomë, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Patologët, patologu nuk ka qenë në pozicion të
22 konfirmonte, nuk ka arritur të konfirmonte nëse fraksionet
23 janë shkaktuar para apo pas vdekjes?

24 PË. Mendoj se sipas tyre këto kanë ndodhur kur personi ka
25 qenë ende gjallë.

1 PY. Por nuk mund të thuhet me siguri ama?

2 PY. Jo, është e pamundur të thuhet kjo me siguri.

3 PY. Nëse këto thyerje janë shkaktuar gjatë kohës që personi
4 ka qenë gjallë, nuk do të ishin fatale, apo jo?

5 PË. Jo, nuk mendoj që do të ishin fatale.

6 PY. Pra, ju jeni i mendimit se nëse këto janë shkaktuar gjatë
7 kohës që personi ka qenë gjallë, ato nuk mund të kenë qenë
8 shkak i vdekjes së këtij personi.

9 PË. Jo. Jo këto lloj thyerje --

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
11 nuk duhet të thoni gjatë të gjithë kohës "po" apo "jo", por
12 duhet patjetër të bëni një pauzë. Jua kam thënë disa herë. Kjo
13 s'është vetëm për ne, është edhe për përkthyesit. Ju lutem.

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

15 PY. Flasim pak shkurtimisht për thyerjen e brinjëve, ju
16 lutem, pjesën e brinjëve. Ky, ky -- kjo kufomë ka pasur
17 thyerje në pjesën e përparme të brinjëve, apo jo? Në kafazin e
18 kraharorit, pra? Pra, *sternum* është kafazi i kraharorit.

19 PË. Po, është në mes të kraharorit.

20 PY. Është gjetur edhe një thyerje brinje në kafazin e
21 kraharorit?

22 PË. Po, ka qenë brinja e tretë që ishte e lidhur
23 drejtpërsëdrejti me kafazin e kraharorit, pak a shumë në të
24 njëjtën pjesë.

25 PË. Pra, shumë afër thyerjes të kafazit të kraharorit?

1 PË. Po.

2 PY. Ju thoni në raportin tuaj që ka mundësi që këto fraksione
3 të jenë shkaktuar gjatë kohës që është përpjekur që personi të
4 rikthehej në jetë.

5 PË. Është mundësi, në fakt, është praktikë në rastet ku
6 personi përpiqet -- kur përpiqen ta kthejnë personin në jetë,
7 ka një lloj çarje të tillë në kafazin e kraharorit. Nuk mund
8 të përjashtohet kjo, por mund të ketë qenë edhe një goditje e
9 fortë në kraharor që mund ta shkaktuar këtë, ose me shkelm ose
10 një objekt. Është edhe kjo një mundësi.

11 PY. Të flasim tani për rikthimin në jetë të një personi.
12 Është normale që kur një person përpiqet të rikthehet në jetë
13 përmes pajisjeve, shpesh thyhen brinjët, apo jo?

14 PË. Po, po. Dhe më shumë se një brinjë, në fakt, mund të
15 thyhen disa brinjë në këto raste.

16 PY. Kjo ndodh sepse nëse përpiqet që një person -- përpiqen
17 që ta reanimojnë një person, ta rikthejnë në jetë, duhet
18 ushtruar forcë e madhe, në mënyrë që të rifilloj lëvizjet
19 zemra?

20 PË. Po. Në kohët moderne, kjo bëhet me aparate, bëhet me
21 aparate. Por për këtë kërkohet një forcë shumë e madhe.

22 PY. Këto fraksione, pra, mund të jenë shkaktuar dhe nga një
23 forcë e tillë e kësaj shkalle?

24 PË. Është një mundësi. Nuk e përjashtojmë. Por ka dhe
25 shpjegime të tjera krejt të mundshme për këtë rast.

1 PY. Në faqen 20 të raportit tuaj, pyetja 4, ju përmendni edhe
2 shkaqe të tjera të mundshme të vdekjes. Në raportin tuaj,
3 thoni që ndër shkaqet e vdekjes mund të përfshihet, plagët nga
4 armët e zjarrit, dëmtimi i trurit, shkaqet natyrale, mbytje --
5 mbytje, mbytje, mbytje nga tymi, mbytje nga uji, mbytje nga
6 asfiksia, intoksimi dhe në asnjë nga këto raste nuk mbeten
7 gjurmë tek skeleti?

8 PË. Po.

9 PY. Pra, a mund të ketë qenë një nga këto shkaqet e tjera,
10 një nga këto arsye të tjera që ka shkaktuar vdekjen e
11 personit?

12 PË. Po.

13 PY. Prokurori ju pyeti lidhur me metodologjinë që është
14 ndjekur dhe nëse mendonit edhe ju që metodologjia e ndjekur e
15 zbatuar në këtë rast nga patologët në këtë autopsi konkrete ka
16 pasur standarde të jashtëzakonshme -- të pranueshme, më falni,
17 për ju. Dhe ju thatë që po, standardet kanë qenë të
18 pranueshme.

19 PË. Unë i njoh personat që kanë qenë të përfshirë në këtë
20 autopsi edhe e di si janë kryer autopsitë në atë periudhë
21 kohore. Prandaj i pranoj gjetjet e tyre. Nuk kam dyshime për
22 gjetjet e tyre.

23 PY. Dr. Morcillo është një patolog me të cilin keni punuar në
24 të shkuarën?

25 PË. Po, kemi punuar.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
2 do të duhet të bëjmë një 10 minuta pushim, nëse mendoni që
3 është kohë e volitshme për ju.

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kam dhe një pyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

6 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

7 PY. Pra, bazuar në përvojën tuaj, jo vetëm që keni punuar me
8 Dr. Morcillo, po me -- bazuar në njohurinë që keni ju për
9 metodologjinë që është caktuar nga këta ndërkombëtarë në
10 Ballkan në atë kohë, dhe ju besoni se metodologjia e prekur
11 prej tyre ka përmbushur standardet që sipas jush janë të
12 pranueshme?

13 PË. Po.

14 PY. Në rregull.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
16 10 minuta pushim, Dëshmitar.

17 DËSHMITARI: [Nuk ka përkthim]

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë 10
20 minuta pushim.

21 --- Seanca ndërpritet në orën 10.02

22 --- Seanca rifillon në orën 10.12

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
24 dëshmitarin në sallë.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
2 keni fjalën.

3 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

4 PY. Z. Clark, siç e shohim në këtë faqe në ekran ky raport
5 është shqyrtuar edhe një doktor, Pablo --

6 PË. Jose Pablo Baraybar.

7 PY. Është person ky që keni punuar me të në të kaluarën?

8 PË. Po, shumë.

9 PY. Z. Baraybar është antropolog i mjekësisë ligjore i
10 njohur?

11 PË. Është antropolog, nuk është doktor.

12 PY. Ka doktor shkencash në antropologji?

13 PË. Po.

14 PY. Antropologjia e mjekësisë ligjore është studimi i
15 mbetjeve njerëzore apo, siç e përshkruat ju në raportin tuaj,
16 ekzaminimi i skeleteve, apo jo?

17 PË. Po. Ata kanë ekspertizë të veçantë në ekzaminimin e
18 kockave, eshtrave, mosha, gjinia, e tjera. Ky është
19 specialiteti tyre.

20 PY. Antropologjia e mjekësisë ligjore është nënkategori e
21 antropologjisë fizike?

22 PË. Po.

23 PY. Që merret, ndërhyr për në zgjidhjen e çështjeve penale?

24 PË. Po. Dhe veçanërisht në interpretimin e plagëve, janë të
25 specializuara në këtë gjë.

1 PY. Kjo është puna që z. Baraybar bën?

2 PË. Po.

3 PY. A pajtoheni se antropologjia e mjekësisë ligjore është
4 fushë ndryshe nga ekspertiza shkencore?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe siç e përmendët, antropologët e mjekësisë ligjore,
7 ndryshe nga patologët, nuk janë doktorë?

8 PË. E saktë. Nuk janë doktorë të mjekësisë pra.

9 PY. Është e zakonshme që patologët dhe antropologët të
10 punojnë së bashku, në situata siç janë, për shembull, zonat
11 pas konfliktit?

12 PË. Po. Shumë kemi punuar në Bosnje, Kroaci, bashkëpunimi
13 ishte kyç mes doktorëve dhe antropologëve, është thelbësore,
14 shumë e rëndësishme në një punë të tillë.

15 PY. Ju e ndihmoni njëri-tjetrin në punën që kryeni?

16 PË. Po.

17 PY. Megjithatë, puna juaj është e ndarë, keni punë të ndara?

18 PË. Ata na ndihmojnë me gjetjet, na udhëzojnë në aspektin
19 teknik lidhur me plagët e trupave, rivendosin eshtrat së
20 bashku. Roli jonë kryesor është interpretimi, çfarë do të
21 thotë kjo që bëhet në një fazë të dytë pra. Pra, një plagë e
22 shkaktuar nga plumbi në një kockë të caktuar unë e di se cila
23 është pasoja e saj, sepse di indet e trupit rreth kësaj kocke.
24 Pra, ky është roli jonë.

25 PY. Por pajtoheni se ata kanë një ekspertizë të

1 jashtëzakonshme dhe të vetme në atë që bëjnë?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe po të duam të diskutojmë me një antropolog të
4 mjekësisë ligjore, të bisedojmë për gjetjet, konstatimet e
5 tyre apo përmbajtjet e raporteve që ata kanë përpiluar,
6 personi më i përshtatur për këtë është vetëm antropologu i
7 mjekësisë ligjore?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe ju pranoni që antropologët ka një ekspertizë që
10 patologët nuk e kanë?

11 PË. Po, është e saktë mendoj. Ka patologë që nuk mund të mos
12 jenë dakord me këtë sepse ka antropologë të mjekësisë ligjore
13 që nuk gjenden kudo në botë. Dhe në disa vende patologët bëjnë
14 punën e antropologut, në Bosnje, për shembull, patologët janë
15 ata që kryesisht bëjnë punën e antropologut, interpretimin e
16 kockave dhe janë shumë të zotët në këtë.

17 PY. Sipas mendimit tuaj, është fushë ekspertize e ndryshme
18 pra dhe kështu e kuptoni ju?

19 PË. Po.

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen 21.

21 PY. Ky është raporti mbi të cilin kishte disa mos apo
22 keqkuptime për disa mbetje, identifikimin e saktë, e të tjera,
23 a ju kujtohet?

24 PË. Po. E kemi zgjidhur këtë më duket.

25 PY. Dhe tani jeni i bindur që keni -- është e qartë

1 mjaftueshëm lidhur me atë, me raportet që kanë të bëjnë me
2 këtë kufomë?

3 PË. Po.

4 PY. Duke parë këtë raport dhe komentet tuaja, shkurtimisht,
5 këto ishin mbetje të këtyre individëve pjesërisht të
6 skeletizuara?

7 PË. Po.

8 PY. Nuk ka fotografi të autopsisë në këtë rast?

9 PË. Unë nuk kam. Ndoshta janë, me siguri që janë bërë
10 fotografi, por unë nuk i kam parë.

11 PY. Nuk ka, në dokumente që keni shqyrtuar nuk ka tregues që
12 në momentin e autopsisë truri ishte i ruajtur, truri?

13 PË. Nuk ishte i pranishëm.

14 PY. Shkaku i vdekjes për këta individë është dhënë në raport
15 mbështetës si një traumë e shkaktuar nga një goditje e
16 fuqishme, a është e saktë?

17 PË. Po.

18 PY. Tani në qoftë se shikojmë në krye të raportit tuaj,
19 shohim se kjo është autopsi që është bërë në Kosovë në verën e
20 vitit 1998?

21 PË. Jo. Autopsia është bërë --

22 PY. Kërkoj ndjesë. Në maj 2005.

23 PË. Po.

24 PY. Janë identifikuar plagë si thyerje, fraktura që janë
25 gjetur në kafkën e individit?

1 PË. Kryesisht fraktura në anën e majtë të pjesës së poshtme
2 të nofullës, mandibula dhe një frakturë tjetër në pjesën e
3 poshtme të kafkës. Pra, menduam, përshtypja ishte që ishte e
4 njëjta goditje apo impakt në anën e nofullës dhe forca e ka
5 transmetuar pastaj në pjesën e poshtme të kafkës.

6 PY. Në mungesë të trurit nuk është e mundur të konstatohet
7 shkalla e ndonjë apo madhësia e ndonjë plage të trurit apo
8 indeve të buta që mund të jenë shkaktuar si rezultat i traumës
9 nga një goditje e fuqishme?

10 PË. Saktë.

11 PY. Në mungesë të trurit dhe duke marrë parasysh vendndodhjen
12 e frakturës në nofull dhe në pjesën e poshtme të kafkës, a
13 mendoni që dikush mund arrijë me bindje në përfundimin në këto
14 rrethana se kjo frakturë thyerje është ka qenë shkaku i
15 vdekjes?

16 PË. Nuk mund të jem 100 për qind i sigurtë por do të thoja me
17 bindje që kjo me shumë gjasa ka qenë shkaku i vdekjes. Është e
18 vështirë të -- kjo është bërë pas në fazën pas *post-mortem*
19 pra. Dhe dimë që kemi frakturën që është në bazë të kafkës që
20 ka kalon tek strukturat jetësore të trurit, pra, afër dhe kjo
21 është plagë e rëndë dhe ka mundësi, ka gjasa, që t'i shkaktojë
22 dëme jetësore trurit.

23 Pra, e pranoj këtë si shkakun e vdekjes.

24 PY. Kemi parë që ka dhe qasje paralele, qasje paralele sa i
25 takon ekzaminimit të mbetjeve skeletore në këtë qasje Dr.

1 Dunjic që e pamë më herët, i cili i përket një shkolle apo
2 metodologjie që sipas të cilës në mungesë të indeve të buta,
3 një qasje, merret një qasje tjetër për të përcaktuar shkakun e
4 vdekjes. Tani, një patolog i kësaj shkolle dhe në këto
5 rrethana, a do të konstatonte dhe ai që shkakun e vdekjes në
6 këtë rast është i papërcaktueshëm?

7 PË. Mund ta kishte bërë. Por ajo që do thoja unë që është
8 interesante në raportin e konsoliduar të Dr. Dunjic është që
9 ai tregohet shumë i kujdesshëm sa i takon plagëve të
10 shkaktuara me armë zjarri, por nuk është aq i pasigurte kur
11 bëhet fjalë për traumat e tjera që ai përshkruan dhe pranon që
12 traumat e tjera, frakturat e tjera janë shkaktuar gjatë jetës
13 dhe është dallim interesant që ndërsa nuk duket që pranon
14 lehtë që plagët e armëve të -- traumat nga plagët e armëve të
15 zjarrit, ai pranon traumat e shkaktuara nga një goditje e
16 fuqishme, pra, që nuk janë nga armë zjarri.

17 PY. Ndoshta që ta -- ju përshkruat -- që të përshkruajmë këtu
18 që kjo shkollë, kjo metodologji si është më e pastra që
19 përshkruat ju sipas mendimit tuaj kur biseduat për patologët
20 në mënyrë më gjerësisht. Pra, në këtë metodologji më të rreptë
21 ndoshta dhe në këto rrethana shkakun e vdekjes është i
22 papërcaktueshëm për ata, pra, na është fshirë, nuk mund ta
23 përcaktojmë?

24 PË. Po. Ka disa njerëz që do të bënin këtë gjë.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Mund të kalojmë në faqen 24 të

1 raportit.

2 PY. Dr. Clark, e keni konstatuar që nuk do të merrem me
3 gjetjet në raportin tuaj të personit me të cilin u morëm në
4 faqen 23. E trajtuam këtë. Ka gjetje aty, konstatime. A është
5 e saktë që është e saktë që autopsia është bërë nga Dr.
6 Morcillo dhe jo nga ju?

7 Atëherë faqja 24. Ky është personi i fundit i vdekur që
8 keni trajtuar në raportin tuaj, faqja 24.

9 A është e saktë, Dr. Clark që lidhur me këtë person juve
10 nuk ju është dorëzuar raport autopsie, ajo që ju është dhënë
11 juve është certifikata e vdekjes për këtë person dhe disa
12 imazhe të marra gjatë zhvillimit të bërjes së autopsisë, është
13 kështu?

14 PË. Po. Kisha harruar fotografitë, po.

15 PY. Pajtoheni që ishin të cilësisë së dobët?

16 PË. Po.

17 PY. A është ky edhe një shembull tjetër, siç e përmendët në
18 fillim, që këto kishin dobi të pakët ose fare në analizën tuaj
19 duke patur parasysh cilësinë e dobët të tyre?

20 PË. Që të jem i saktë, nuk është detyrimisht cilësia e dobët
21 e fotografisë origjinale, po mund të jetë që janë bërë
22 fotokopje apo janë riprodhuar këto fotografi. Por mund të
23 kishte përdorim të pakët të tyre, mund të nxirrnim pak nga
24 këto.

25 PY. Fotografitë që ju janë dhënë juve nga Prokuroria, në

1 gjendjen që i keni pranuar, nuk ishin të përshtatshme për t'u
2 përdorur për atë qëllim?

3 PË. Në ato fotografi shiheshin disa tipare, karakteristika,
4 por për përdorim të kufizuar.

5 PY. Juve ju janë bërë disa pyetje konkrete nga Prokuroria
6 lidhur me gjetjet e shënuara në certifikatën e vdekjes.

7 Certifikata e vdekjes përmban se një shok hemorragjik i rëndë,
8 që përputhet me gjetjet, përputhet me gjetjet që personi është
9 vrarë.

10 Fillojmë me pyetjen e parë, ju Prokurori iu ka bërë
11 pyetje nëse gjakderdhja e rëndë ishte në përputhje me
12 konstatimin që personi është vrarë.

13 Tani, duke u ndaluar tek përshtatshmëria e kësaj pyetjeje
14 dhe duke parë përgjigjen tuaj në gjetjet, a është e saktë Dr.
15 Clark që gjakderdhja e rëndë, shoku hemorragjik mund të jetë
16 vdekjeprurës?

17 PË. Po.

18 PY. Kjo gjë a mund të shkaktohet nga një traumë, nga trauma
19 mbi trup por mund të shkaktohet dhe nga një sëmundje e
20 natyrshme?

21 PË. Po.

22 PY. Në të dy këto raste mund të shkaktojë vdekjen?

23 PË. Po.

24 PY. Në dokumentacionin që keni marrë nuk kishte informacion
25 lidhur me ndonjë gjakderdhje nën lëkurë të madhe, fraktura të

1 eshtrave apo ndonjë organ të dëmtuar, bëhet fjalë me shkrim, a
2 është kështu, nuk kishte informacion të tillë?

3 PË. Ishte një fotografi e mëlçisë që tregonte diçka, supozoj
4 që ishte arteria në mëlçi nga ku vinte gjaku.

5 PY. Ndalojmë këtu një çast, Dr. Clark. Që të jemi të qartë në
6 procesverbal, a mund të konfirmoni që është e saktë që në
7 materialin me shkrim që keni marrë nuk kishte asnjë shënim për
8 gjakderdhje nën lëkurë, thyerje kockore apo organe të
9 brendshme të dëmtuara? Dhe pastaj do merremi me fotografinë
10 dhe interpretimin e tyre pas pak.

11 PË. E saktë, nuk ka asgjë me shkrim.

12 PY. Materiali me të cilin është dash që të punoni, siç e keni
13 identifikuar ju, ishin fotografitë të cilësisë së dobët?

14 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Pyetje e bërë,
15 përgjigjur dhe po fillojmë sërish me të njëjtën gjë që e kemi
16 trajtuar.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

18 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] A mund të qartësoj pyetjet që po
19 bëja unë? Lidhet me fotografitë dhe cilësinë e tyre të dobët.

20 Z. PACE: [Përkthim] Kjo ka të bëjë me pyetjen që sapo u
21 bë më lart dhe për këtë kundërshtova.

22 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

23 PY. Z. Clark, për këtë të vdekur, duke patur parasysh mungon
24 raporti i autopsisë dhe cilësia e materialeve që ju janë dhënë
25 juve, a jeni në gjendje sot të konfirmoni me pa mëdyshje se ky

1 person vdiq së pari nga shoku hemorragjik i thellë, i rëndë?

2 PË. Nuk mund ta konfirmoj këtë bazuar në fotografitë.

3 PY. Që të shkojmë pak më larg, për rrjedhojë, është e
4 pamundur për juve, në qoftë se është kështu siç e thatë, që të
5 konfirmoni se ka qenë shok hemorragjik i shkaktuar nga një
6 goditje, nga trauma si pasojë e goditjes së fuqishme?

7 PË. Kjo mund të jetë certifikatë vdekjeje e saktë, por nuk
8 kam bazë për të konfirmuar këtë gjë, nuk kam informacione për
9 ta bazuar, mbi të cilat është bazuar kjo. Dhe nuk mund ta
10 konfirmoj.

11 PY. Nuk jeni në gjendje të konfirmoni saktësinë e gjetjeve
12 mbi të cilat mbështetet kjo në mungesë të materialeve?

13 PË. Saktë.

14 PY. Dhe është e saktë të themi që nuk jeni në gjendje, në
15 mungesë të informacioneve të tjera, që të konfirmoni që kjo
16 është gjetje e besueshme mbi të cilën mund të mbështetemi?

17 PË. Saktë.

18 PY. Për rrjedhojë, a është e saktë të themi që ju nuk jeni në
19 gjendje të konfirmoni apo që të pranoni këtë gjetje,
20 konstatim, sikur të ishte i juaji?

21 PË. Po.

22 PY. Z. Clark, dje pjesa dërrmuese e pyetjeve që ju bënë juve
23 nga Prokurori kishin të bënin me një të vdekur që nuk është
24 pjesë e raportit tuaj. Ju kujtohen këto pyetje? Kishin të
25 bënin me një person që e pamë në një fotografi në pozicion të

1 ulur?

2 PË. Po.

3 PY. Është e saktë, pra, që juve ju kërkua që të jepnit vetëm
4 mendimin tuaj, opinionin tuaj lidhur me këtë person dhe
5 rrethanat për herë të parë kur jeni takuar me Prokurorin në
6 Zoom, më duket javën e kaluar?

7 PË. Më 9 janar, po.

8 PY. Dje ju na shpjeguat komentet, konstatimet që ju keni bërë
9 bazuar në fotografitë që ju janë dhënë?

10 PË. Po.

11 PY. A është e saktë atëherë që për këtë person juve nuk ju
12 është dhënë raporti i autopsisë dhe, me sa kuptojmë, nuk është
13 bërë autopsi këtij personi, është kështu?

14 PË. Unë nuk kam parë raporte autopsie.

15 PY. Juve ju është dhënë dokumentacion për të punuar ku
16 përfshiheshin shënimet e një doktori të ushtrisë i cili kishte
17 ekzaminuar kufomën në momentin e gjetjes?

18 PË. Më është treguar kjo gjë. Nuk më është dhënë mua, më
19 është treguar.

20 PY. Nuk ju është dhënë një kopje që ta mbanit?

21 PË. Jo.

22 PY. Ju është treguar gjatë bisedës që keni patur në Zoom me
23 Prokurorin?

24 PË. Po.

25 PY. Nuk do t'ju kërkohet që të përsërisni atë që keni thënë

1 lidhur me mavijosjet siç e keni konstatuar tek ky person. Do
2 t'ju pyes thjesht për moshën e atij personi. Ju lutem më
3 lejoni në qoftë se keni nevojë që të shfaqim në ekran
4 fotografitë. Unë nuk kam qëllim që t'i kërkoj në ekran, por në
5 qoftë se keni nevojë i nxjerrim.

6 Juve ju kujtohet që e keni vërejtur një mavijosje të
7 këtij personi të vdekur në kofshë?

8 PË. Po.

9 PY. A pajtoheni që kjo mavijosje në kofshë dukej të ishte më e
10 vjetër dhe më e nxirë në ngjyrë sesa mavijosjet e tjera që
11 shiheshin mbi këtë person të vdekur?

12 PË. Nuk pajtohem me juve mbi këtë pikë. Mua mu duk si
13 mavijosje e freskët në fakt. Mavijosjet janë shumë të vështira
14 që të përcaktohen momenti i shkaktimit të tyre. Kjo mua mu duk
15 e freskët relativisht, një, dy ditë më parë. Nuk do ta
16 klasifikoja si mavijosje të vjetër që do të ishte ndoshta
17 ngjyrë të jeshilët të verdhë, që do të ishte disa ditë e
18 vjetër. Ajo që mund të them unë është që ka qenë ndoshta dy
19 ditë e vjetër.

20 PY. A është mendimi juaj, pikëpamja juaj që kjo mavijosje
21 ishte dy apo tre ditë e vjetër, kjo që keni vërejtur ju, kjo
22 vlen vetëm për atë që ishte mbi kofshë apo kjo vlen edhe për
23 mavijosjet që keni parë në pjesë të tjera të trupit të
24 personit të vdekur?

25 PË. Vlen në përgjithësi për të tjerat. Nuk kishte asgjë që më

1 tërhoqi mua vëmendjen si tipar i një mavijosje të vjetër. Të
2 gjitha mu dukën pak a shumë të të njëjtit moment, që janë
3 shkaktuar në të njëjtin moment. Pra, do të thoja që ishin të
4 gjitha të ngjashme.

5 PY. Pra, një, dy ditë të vjetra?

6 PË. Një, dy ditë. Ndoshta deri në tre ditë. Persona të
7 ndryshëm reagojnë ndryshe ndaj mavijosjeve. Mua mu dukën
8 relativisht të freskëta si mavijosje.

9 PY. Nga ajo që keni parë në fotografi është e saktë që, sipas
10 mendimit tuaj, ju nuk prisnit traumën e shkaktuar nga një
11 goditje e fuqishme, pra, që kërkohet, pra, forcën që kërkohet
12 për të shkaktuar këto mavijosje, nuk prisni që kjo të jetë
13 shkaktuar lëndim të eshtrave?

14 PË. Mendoj që mund të ketë thyer ndonjë brinjë sepse ishin
15 relativisht të brishta sepse ato janë relativisht më të
16 brishta tek personat më të moshuar, por nuk mund të mendoj.
17 Edhe pse ishte një mavijosje në kofshë, në pjesën e kofshës,
18 nuk shkakton thyerjen e femurit kjo gjë. Mund t'i ketë
19 shkaktuar ndonjë thyerje të brinjëve megjithatë.

20 PY. Mendoj që dje në dëshminë tuaj thatë që është -- ndërsa
21 është -- edhe pse është e mundur, sipas mendimit tuaj, ka pak
22 gjasa?

23 PË. Po.

24 Z. PACE: [Përkthim] A mund të kërkohet referencën për
25 këtë, të nderuar Gjykatës? Sepse nuk më kujtohet.

1 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Do të kërkoj që të shfaqet në
2 ekran.

3 PY. Do mundeni që të vazhdoni me përgjigjen?

4 PË. Nuk më kujtohet që kam thënë që frakturat ose thyerjet
5 kanë pasur pak të ngjarë që të ndodhin.

6 Z. PACE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpresë, të
7 nderuar Gjykatës. Por unë e gjeta referencën dhe nuk më duket
8 sikur ka thënë këtë gjë dëshmitari.

9 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në qoftë se kolegu dëshiron që ta
10 lexojë këtë pjesë është në rregull.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk e kam referencën.

13 Z. PACE: [Përkthim] Sapo e thashë referencën. Dhe jo
14 vetëm kaq, po sipas Urdhrit për Zhvillimin e Procedurave, kur
15 bëjmë pyetjet është e nevojshme që të kemi të gatshëm edhe
16 referencën përkatëse.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
18 nuk e paraqisni dot referencën, atëherë mos e bëni fare
19 pyetjen.

20 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Në rregull. A mund të vazhdoj më
21 tej apo jo, sepse është e nevojshme që ta bëjmë. Në qoftë se
22 kolegu dëshiron që ta lexojë për procesverbal, mund ta lexojë.
23 Sepse neve na duhet pak kohë sa ta identifikojmë.

24 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk është puna
25 ime që të jap referencën.

1 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po e gjejmë, po e kërkojmë

2 ndërkohë. Nuk e kemi për momentin, por do ta gjejmë.

3 Z. PACE: [Përkthim] E përsërisë edhe një herë, që është

4 faqja 24243, dhe ndërkohë në rreshtin 12 bëhet pyetja dhe

5 përgjigja jepet në rreshtin 17, për procesverbal.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, z.

7 Pace, lexojeni pjesën. Lexojeni, ju lutem. Besoj që do

8 procedojmë më shpejt në këtë mënyrë.

9 Z. PACE: [Përkthim] Po, patjetër.

10 "PY. Duke u përqendruar tek lëndimet që ju përshkruat në

11 pjesën e kraharorit, sipas mendimit tuaj, lëndime të tilla

12 janë shkaktuar -- kanë shkaktuar dhe lëndim të organeve të

13 brendshme?

14 "PË. Ka pak të ngjarë që të jetë e mundur kjo. Dhe thoni

15 gjithashtu që mund të ketë pasur lëndime të tjera që ndoshta

16 ne nuk i kemi konstatuar më poshtë në organe."

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

18 PY. Pra, ju i keni përmendur fjalën "ka pak të ngjarë" "ka

19 pak gjasa" dy herë. Tani, z. Clark edhe një herë pyetja për

20 juve është kjo: A mund të na e sqaroni, në qoftë se sipas

21 mendimit , trauma e forcës që ju keni vëzhguar në kraharor ka

22 shkaktuar edhe lëndime të tjera më poshtë, pra, në organe?

23 PË. Unë kam thënë që ka pak gjasa që të jenë shkaktuar

24 dëmtime në organet poshtë lëkurës, domethënë, te mushkëritë

25 ose tek zemra, të paktën nga lëndimet që kam parë. Ndoshta

1 mund të ketë pasur fraktura, mund të ketë pasur thyerje, por
2 ka pak gjasa që të ketë ndodhur diçka tjetër në më tepër
3 thellësi.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
5 thuajse keni tre orë tani që bëni pyetje, kështu që duhet që
6 të përfundoni sa më shpjet të jetë e mundur.

7 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Është grupi i fundit i pyetjeve.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
9 Vazhdoni.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim]

11 PY. Z. Clark, do t'ju lexoj dhe më thoni në qoftë se doni që
12 ta lexoni dhe vetë dokumentin sepse në këtë rast do të duhet
13 që të kërkoj nga Sekretaria që të paraqesë dokumentin
14 përkatës. Por, bëhet fjalë për një raport të Dr.

15 Schreckenbauer që ka pasur mundësi, sepse sikurse e keni thënë
16 edhe më herët kam përshtypjen që Prokuroria nuk jua ka dhënë
17 këtë dokument, kështu që për këtë arsye dua që t'jua lexoj atë
18 çfarë ka shkruar ai. Këto janë shënimet e tij pas marrjes në
19 pyetje të personave -- shqyrtimit ose këqyrjes - më falni - të
20 personave që kemi parë në fotografi.

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Dhe për personat të cilët po na
22 ndjekin për referencë dokumenti është SITF00189121 deri në
23 SITF000189141-ET E Rishikuar dhe tani më thonë që ky dokument
24 ka marrë numrin e provës P858.

25 PY. Megjithatë, përpara sesa të lexoj shënimet e tij për ju,

1 z. Clark, dua t'ju sqaroj se ai thotë, domethënë, qëndrimi i
2 tij është nuk kryer asnjë lloj autopsie për trupin sepse në
3 shënimet e tij thuhet:

4 "Raporti i autopsisë, në ndërtesën e MUP-it ..."

5 Pra, duhet që ta mbani parasysh këtë gjë, domethënë, nuk
6 ka asnjë sugjerim ose supozim që është bërë ndonjë autopsi.

7 "... më 18 qershor 1999, në orën 16.30.

8 "Është një trup i një mashkulli rreth 70 vjeç, koha e
9 menduar e vdekjes ka qenë më 18 qershor 1999, në orën 03.00
10 ose më përpara.

11 "Ka shenja tek pjesa e nofullës, ka gjithashtu edhe
12 shenja në gishta, në pjesën e këmbëve poshtë, në gishtat e
13 këmbëve, në pjesën e pasme të kofshëve dhe personi është
14 gjendur në një pozicion të ulur.

15 "Karakteristikat e poshtme janë identifikuar që mendohet
16 të kenë ardhur si rezultat i ndikimit me forcë. Ka mavijosje
17 dhe po ashtu ënjtje në pjesën e kraharorit në të majtë e në të
18 djathtë, ka hematomë masive në pjesën e sipërme të shpinës dhe
19 ka mavijosje në kofshë në të djathtë përpara, thuhet
20 gjithashtu që ka gjithashtu një hematomë rreth 15 centimetra
21 në pjesën e kofshës së majtë, pjesa e përparme.

22 "Nuk munda të identifikoja një plagë prej armëve të
23 zjarrit apo një plagë prej një thike ose të mbytjes së
24 personit.

25 "Dhe sa i takon gjërave të tjera të cilat janë gjetur në

1 këtë person janë që është gjetur karta e identitetit e tij,
2 150 dinarë dhe kaq.

3 "Sa i takon vlerësimit:

4 "Mavijosja sipas mendimit tim nuk përfaqësojnë një lëndim
5 fatal, në këtë rast do kishte të ngjarë që ky person të kishte
6 vdekur si rezultat i arrestit kardiak."

7 Z. Schreckenbauer u pyet më pas nga Prokuroria, pra, më
8 vonë, që të shtjellonte vlerësimin e bërë prej tij më herët
9 dhe në përgjigje ai tha si më poshtë.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Për personat që po ndjekin bëhet
11 fjalë për dokumentin KSC-BC-2020-06 faqja e procesverbalit
12 07320 deri në 073256, faqja konkrete është 071346.

13 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem paraqiteni në ekran në
14 mënyrë që mund ta ndjekim.

15 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk është pjesë e dokumenteve
16 tona.

17 Z. PACE: [Përkthim] Atëherë në qoftë se nuk është pjesë
18 dokumenteve të Mbrojtjes, nuk e di se si mund të bëjmë neve
19 konstatime në qoftë se informacioni që do të lexojë znj. Rowan
20 është i saktë apo jo?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
22 paraqiteni dokumentin në ekran.

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] A mund të na e lejoni
24 edhe një herë numrin ERN?

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po, patjetër. Është KSC-BC-2020-06

1 071320 deri në 071356-ET RED.

2 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
3 këshillohen]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po përpiqemi
5 të gjejmë dokumentin.

6 ZNJ. ROWAN: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 [Përkthim] Në interes të kohës, ndërkohë në qoftë se më
8 lejoni mund t'jua lexoj këtë paragraf dëshmitarit.

9 Z. PACE: [Përkthim] Neve kundërshtojmë këtë kërkesë sepse
10 nuk kemi pasur asnjë lloj njoftimi që Mbrojtja do ta përdorë
11 këtë dokument, sepse ne zakonisht, rregulli është që të
12 informohemi ose të njoftohemi për dokumentet që përdorë
13 Mbrojtja. Dhe nuk jemi të përgatitur që të bëjmë kundërpyetje
14 lidhur me të. Kështu që në këtë rast një paragraf i izoluar
15 nuk mendoj që do të ndihmojë shumë dhe jemi kundër kësaj
16 procedure të të vijuarit.

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Është faqja 071346.

18 Atëherë le të vazhdojmë më poshtë në të djathtë.

19 Faleminderit. Ky është dokumenti.

20 PY. Thujse e gjetëm, z. Clark. Kur u pyet në një fazë të
21 mëvonshme lidhur me këtë vlerësim, z. Schreckenbauer tha si më
22 poshtë në përgjigje të kësaj pyetjeje:

23 "Në 'vlerësimin' tuaj në fund të raportit thuhet se
24 mavijosjet nuk kanë qenë dëmtime fatale, por që ishte, 'ka
25 qenë e mundur që vdekja të jetë shkaktuar nga një arrest

1 kardiak'. Në qoftë se kjo është e mundur, a mund të na e
2 shpjegoni sesi keni mbërritur në këtë përfundim."

3 Përgjigja është kjo:

4 "Lëndimet e dallueshme në trup nuk kanë qenë kaq shumë të
5 rënda sa mund të lidheshin me vdekjen. Po ashtu, kam vërejtur
6 në raportin tim që shkaku ekzakt i vdekjes mund të përcaktohet
7 vetëm përmes një autopsie. Për shkak të moshës së vjetër të
8 personit të vdekur mund të ketë ndodhur që vdekja të jetë
9 shkaktuar nga një tjetër shkak. Lëndimet tek personat e tjerë
10 të lënduar ishin të ngjashme në ... natyrë dhe masa e lëndimit
11 ose e dëmtimit ishte e tillë sa nuk mund të ketë shkaktuar
12 vdekje ose përfundim fatal."

13 A e shikoni këtë?

14 PË. Po.

15 PY. A pajtoheni me mua që vlerësimi i Dr. Schreckenbauer
16 përfshin tre pjesë kryesore: së pari, që sipas mendimit të
17 tyre mavijosjet nuk përfaqësojnë një përfundim fatal ose
18 vdekjen e personave; së dyti, kemi tabletat të cilat tregojnë
19 që mund të ketë pasur një problem vaskular kardiak personi;
20 dhe, së treti, që doktori thotë që vdekja mund të jetë
21 shkaktuar edhe nga një arrest kardiak? A pajtoheni ju me mua
22 që këto janë tre aspektet e vlerësimit të tij mbështetur në
23 ato që sapo ju lexova?

24 PË. Po.

25 PY. Juve Prokuroria nuk jua kanë treguar këtë, domethënë, po

1 ju kanë treguar vlerësimin e mjekut, apo jo?

2 PË. Po. Jo ky dokument nuk më është treguar ky dokument, po
3 më është treguar komenti origjinal.

4 PY. Domethënë, unë këtë jua tregova për t'ju dhënë pak më
5 shumë kontekst për përgjigje.

6 A ka ndonjë gjë tjetër në fotografi ose në dokumentet që
7 ua ka dhënë ZPS-ja që do ju bënin ju të mos pajtoheshit me
8 vlerësimin e z. Schreckenbauer?

9 PË. Jo, nuk jam se nuk pajtohem. Por thjesht do shtoja diçka.
10 Nuk është se nuk pajtohem se lëndimet e para që ne shohim që
11 nuk kanë qenë fatale. Po ndërkohë mund të ketë edhe lëndime të
12 tjera të cilat neve nuk i kemi parë. Për shembull, mund të
13 ketë lëndime në kokë të cilat nuk mund të shikohen me sy të
14 lirë. Ose mund të ndodhë që të ketë pasur, për shembull,
15 dëmtime të tjera të brendshme, për shembull, mund të ketë pas
16 probleme në kraharor ose goditja në kraharor mund të ketë çuar
17 në shkatërrimin e mushkërisë e të tjera.

18 Ndërkohë që sa i takon tabletave, përgjithësisht këto
19 janë tableta të cilat jepen për personat të cilët kanë
20 probleme me zemrën. Kështu që këtu nënkuptimi është që personi
21 mund të ketë pasur ndonjë problem kardiak, pra, problem me
22 zemrën. Po ashtu është e vërtetë që personi mund të ketë
23 vdekur në çdo moment nga ky problem që ka pas me zemrën.
24 Megjithatë besoj që do ishte e drejtë që të shtohet po ashtu
25 se këto lëndime të jashtme nuk është se janë jo domethënëse,

1 pra, janë të konsiderueshme dhe mund të ketë ndodhur që
2 personi të ketë vdekur nga ataku në zemër si rezultat i
3 stresit që ka pësuar nga lëndimet e marra, mund të jetë edhe
4 ky rasti.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
6 përfundoi koha.

7 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po, do përfundoj.

8 PY. Kur thoni që "dua t'i shtoj kësaj", a është e drejtë që
9 qëndrimi juaj, pozicioni juaj është që ka disa mënyra ose disa
10 shkaqe nga të cilat mund të ketë vdekur ky person dhe nuk
11 është e mundur që të thuhet me 100 për qind siguri se cili
12 është shkaku i vdekjes përmes autopsisë?

13 PË. Po.

14 PY. E kam edhe një çështje tjetër që dua ta ngre shkurtimisht
15 që ka të bëjë me kohën e vdekjes. Kjo është një linjë pyetjesh
16 të cilat ua bëri dhe Prokuroria. Prokuroria, Prokurori më
17 saktë, ua vuri në pah në seancën përgatitore që është shënimi
18 i Prokurorisë në diskutime, në bisedat që keni bërë përmes
19 Zoom, që sipas mendimit tuaj, trupi ishte relativisht i
20 freskët. A është një përshkrim i saktë ky?

21 PË. Po.

22 PY. Domethënë, në mendimin tuaj trupi kishte disa orë të
23 paktën që ishte i vdekur, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Sipas mendimit tuaj, a është e mundur që këto fotografi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: John Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Rowan (Vazhdim)

Faqe 56

1 të jenë bërë ndoshta, në qoftë se janë bërë pasdite vonë ose
2 në mbrëmje që personi mund të ketë qenë i gjallë në mëngjes?
3 PË. Po, me shumë gjasa po.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
5 bëjmë gjysmë ore pushim dhe do kthehemi përsëri në orën 11.30.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
8 pushim deri në orën 11.30.

9 --- Pauza fillon në orën 10.56

10 --- Seanca rifillon në orën 11.31

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
12 silleni dëshmitarin në sallë.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
15 këshillohen]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 [Përkthim] Presim sa të shfaqet personi në ekran.

18 Dëshmitar, duhet të presim sa të shfaqet dikush në
19 videolidhje.

20 Ndërkohë që presim, Znj. Tavakoli, a keni pyetje?

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo, nuk kam.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully?

23 Z. TULLY: [Përkthim] As ne s'kemi pyetje.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

25 Alagenda?

1 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Kemi shumë pak pyetje. Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Për një
3 çast do fillojmë atëherë.

4 [I akuzuari Thaçi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
7 Kemi dhe z. Thaçi që po na ndjek.

8 Znj. Alagendra, fjala është për ju.

9 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

10 Pyetje të palës tjetër nga znj. S. Alagendra:

11 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

12 PY. Mirëmëngjesi, Dr. Clark.

13 I AKUZUARI THAÇI: [Përmes videolidhjes] Z. Kryegjyqtar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

15 Faleminderit, që erdhët, z. Thaçi. Faleminderit që u kthyet.

16 Keni një pyetje, doni të thoni diçka?

17 I AKUZUARI THAÇI: [Përmes videolidhjes] Po, të kalojmë në
18 seancë private, të lutem.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në seancë
20 private.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani mund të
4 vazhdoni, znj. Alagendra.

5 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

6 PY. Dr. Clark, un quhem Shyamala Alagendra dhe përfaqësoj z.
7 Jakup Krasniqi që është ulur pas meje. Kam shumë pak pyetje,
8 nuk do qëndrojmë gjatë bashkë.

9 Dr. Clark, ju keni qenë kryepatologu për TPNJ-në çka do
10 të thotë se e njihni mirë kontekstin e konfliktit në ish-
11 Jugosllavi?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe veçanërisht e njihni mirë kontekstin e Kosovës, e
14 asaj që ka ndodhur në Kosovë?

15 PË. Më pak me Kosovën, do të thoja, kryesisht kam pas dijeni
16 për Bosnjën dhe për Kroacinë.

17 PY. Keni trajnuar patologë në Bosnje dhe në Kroaci dhe në
18 Kosovë?

19 PË. Po dhe në Kosovë.

20 PY. Kjo për të përmirësuar standardet do të ndanit me ta
21 përvojën tuaj?

22 PË. Po.

23 PY. Në jetëshkrimin tuaj ju keni shënuar që keni kryer edhe
24 ekzaminime të rasteve të krimeve të luftës në Kosovë, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Çka do të thotë se ju duhet ta njihni mirë kornizën e
2 zbatueshme sa i takon forensikës në këto juridiksione,
3 patologjisë forensike?

4 PË. Po.

5 PY. Dr. Clark, në një nga raportet e një patologu që keni
6 parë ju dhe që e keni komentuar gjerësisht është e profesor
7 Slavisa Dobricanin.

8 PË. Po.

9 PY. Me këtë profesor keni pasur ndonjë kontakt personal apo
10 profesional?

11 PË. Jo.

12 PY. A pajtoheni me mua, Dr. Clark, që një ekspert duhet të
13 jetë në gjendje dhe duhet të japë prova objektive, të paanshme
14 dhe të pavarura në fushën e vet të ekspertizës?

15 PË. Po.

16 PY. A pajtoheni ju me mua që të gjithë ekspertët kanë për
17 detyrë të japin çdo informacion që ka në informacion për të
18 forcuar besueshmërinë e një raporti dhe për të forcuar faktin
19 që kanë qenë të paanshëm?

20 PË. Po.

21 PY. Veçanërisht në rastet e TPNJ-së apo të kësaj Gjykate a do
22 pajtoheshit ju me mua që anshmëritë nacionaliste ideologjike
23 dhe personale të ekspertëve, e veçanërisht të ekspertëve që
24 vijnë nga komunitetet e përfshira në konflikt, duhen marrë
25 parasysh kur gjykohet paanshmëria e një eksperti të caktuar?

1 PË. Pajtohem tërësisht.

2 PY. Kur morët udhëzimet nga Prokuroria, a ju dha ndonjë
3 informacion nga ana e Prokurorisë sa i takon besimeve politike
4 apo të personale të profesor Dobricanin që mund të kenë
5 ndikuar në përfundimet e tij?

6 PË. Jo.

7 PY. Në raportin tuaj, në faqen 5 të raportit tuaj, po dhe
8 gjatë dëshmisë ju përshkruat qëndrimin klasik, çka do të
9 thotë, që patologët si rregull nuk vendosin dhe nuk komentojnë
10 lidhur me mënyrën e vdekjes. Ajo është detyrë e prokurorëve
11 apo gjyqtarëve, por patologët analizojnë gjendjen e trupit,
12 përshkruajnë ato çka shohin edhe nxjerrin përfundimet për
13 shkakun e vdekjes?

14 PË. Po.

15 PY. Në atë faqe po ashtu keni përmendur se në vende të tjera
16 të botës, patologët mundet, mundet edhe të vendosin lidhur me
17 mënyrën e vdekjes dhe ju referuat këtu raportit të profesor
18 Dobricanin si një raport që "supozohet" që dhe mund ta ketë
19 ndjekur këtë praktikë. Do të doja të zbërthenim bashkë fjalën
20 "supozohet".

21 Bazuar në përvojën dhe trajnimet që keni kryer në Kosovë
22 dhe shtete të tjera të ish-Jugosllavisë, a e dini ju se cilat
23 janë detyrimet ligjore në Serbi, çka do të thotë, cilat janë
24 detyrimet ligjore sa u takon përfundimeve të patologëve për
25 shkaqet e vdekjes, për shembull, a lejohet atje të jepet

1 përkufizim si vrasja?

2 PË. Jo, unë nuk kam përvojë të drejtpërdrejtë për këtë. Unë e
3 thashë që në fillim, mu duk e pazakontë që dikush ta ketë
4 shkruar këtë edhe unë u përpoqa të gjeja dhe shpjegime, mbase
5 thashë në atë juridiksion lejohet, pritet që patologët të
6 dalin në këtë përfundim. Por mu duk goxha e pazakontë që ishte
7 bërë një koment i tillë.

8 PY. Por ju na citoni dot çfarë ligji mund të ketë në Serbi
9 apo cila është korniza ligjore në Serbi që e parasheh një rast
10 të tillë?

11 PË. Jo.

12 PY. Dr. Clark, a e dini ju që profesor Slavisa Dobricanin ka
13 qenë dëshmitar i mbrojtjes për Milosheviçin në gjykimin e tij
14 në TPNJ, e madje ka qenë dëshmitar fakti në mbrojtje të
15 Milosheviçi për masakrën e Reçakut që besojmë që e njihni? A e
16 dini ju këtë?

17 PË. Jo, unë nuk e dija këtë.

18 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran materialin
19 DJK01160-1161.

20 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Pikësëpari dokumenti në
21 fjalë ka vetëm dy faqe që mendohet që janë nxjerrë nga një
22 dëshmi më e gjatë. Nuk e kemi dëshminë në tërësinë e vet.

23 Së dyti, eksperti është një patolog kriminalistike edhe
24 sa u takon viktimave për të cilat ka akuza në aktakuzë, nuk
25 përmenden viktimat e Reçakut.

1 Kështu që nëse Mbrojtja do të bëj pyetje lidhur me këtë
2 pistë dua të na thotë për ç'qëllim po i bën këto pyetje, cila
3 është relevanca.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cila është
5 relevanca juaj, cili është qëndrimi juaj?

6 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Fillimisht unë desha të
7 merrja opinionin e profesor Clark lidhur me fiziologjinë e
8 kosovarëve, pra, atributet fizike të kosovarëve,
9 karakteristikat të kosovarëve, sepse ka qenë në Kosovë dhe
10 është në gjendje të na japë një mendim. Dhe veç kësaj kisha
11 nevojë për më shumë informacion sa i takon mungesës së
12 paanshmërisë nga ana e profesor Dobricanin.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
14 [Përkthim] Ky dokument është i rëndësishëm po pse?

15 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Dua që Dr. Clark të japi
16 disa komente.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ka ndonjë
18 arsye pse i keni vetëm pjesërisht dokumentin?

19 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Unë mund t'ua të jap të
20 gjithë transkriptin, është dokument publik, po është mbi
21 qindra faqe.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
23 Do ta lejojmë.

24 Rrëzohet kundërshtimi i Prokurorisë.

25 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Në faqen tjetër, ju lutem.

1 Rreshti 11.

2 PY. Dr. Clark, teksti përpara është pjesë e një transkripti e
3 dëshmisë së profesor Dobricanin në ish-Tribunalin e Hagës.
4 Këto janë përgjigjet e tij nga pyetjet që i bëri Dan Saxon
5 është vrasja e një djali 14-vjeçar në atë kohë që ishte
6 goditur pas shpine në atë kohë edhe e pyet ai a ka qenë mbase
7 thjesht një civil i pafajshëm ky fëmijë?

8 Përgjigja e tij është e tillë:

9 "Mes shqiptarëve, për shqiptarët djemtë e asaj moshe
10 konsiderohen në moshë madhore."

11 Mesa keni ju përvojë, keni ju ndonjë provë shkencore që
12 fëmijët shqiptarë rriten më shpejt se fëmijët serbë apo
13 boshnjakë?

14 PË. Jo, nuk e kam një -- nuk mund të flas për këtë, nuk kam
15 prova të tilla.

16 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim tani në ekran
17 DPS00270 deri në 00863, ju lutem, në ekran. Vetëm ballina.

18 PY. Dr. Clark, e keni ndeshur ndonjëherë këtë libër, e keni
19 parë ndonjëherë këtë libër, është libër i Prokurorisë?

20 PË. Jo.

21 PY. Nuk do hyjmë shumë në thellësi, por në faqen 124 të këtij
22 libri --

23 ZNJ. s. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem të vendoset faqja
24 në ekran. 121. 121, ju lutem.

25 PY. Dr. Clark, në këtë pjesë të librit ku thotë "Rezultatet

1 mjeko-ligjore dhe betimi i Hipokratit", në fakt, këtu autori
2 ka shprehur, ka folur për anshmërinë e profesorit Dobricanin
3 pro serb. Unë nuk do ta shtjellojë shumë këtë pjesë, po a ju
4 është vënë ju kjo në dukje?

5 PË. Jo, aspak jo.

6 PY. Ua them këtë Dr. Clark, sepse duke mos pasur dispozita
7 ligjore, të paktën me sa keni ju dijeni, dispozita ligjore që
8 ta lejojnë një patolog ta përkufizojnë një vdekje si vrasje
9 edhe disa nga dëshmitarët tjerë në këtë raport që keni
10 evidentuar në raportin tuaj dhe për të cilët keni dhënë
11 dëshmi, a është e mundshme që faktorë të tillë si persona
12 antishqiptarë të kenë pasur ndikim në përfundimet e këtij
13 personi?

14 PË. Dhe mund të ketë ndodhur. Është e vështirë. Ne të gjithë
15 kemi mendimet tona dhe anshmëritë tona, por do të duhet t'i
16 minimizojmë sa më shumë që të jetë e mundur.

17 PY. Tani flasim për përgjigjet që keni dhënë ju për të pestat
18 viktimat që ishin grupuar së bashku dhe, nuk po i përmend
19 sepse jemi në seancë publike, përfundimet se provat që ju kanë
20 dhënë sugjerojnë se këta burra janë vrarë në vendin ku janë
21 gjetur është bazuar në vlerësimin tuaj se po të ishin gjuajtur
22 diku tjetër dhe trupat do të hidheshin në rrugë, ju mendoni se
23 trupat do të kishin më shumë njolla gjaku?

24 PË. Ky ishte një nga faktorët. Ka dhe faktorë të tjerë. Më
25 treguan fotografi të trupave në vendngjarje. Dhe më duket, që

1 ashtu duket thjesht një person që është rrëzuar atje të paktën
2 në një rast gjunjët janë të përthyer dhe personi ka rënë me
3 shpinë, me kokë pas. Por gjithashtu nuk janë të dëmtuara
4 rrobat. Po të ishte tërhequr trupi do ishin dëmtuar rrobat.
5 Këpucët janë ende të mbathura.

6 Pra, në tërësi unë gjykoj që personat kanë vdekur aty ku
7 janë gjuajtur, ku janë gjetur.

8 PY. Nëse trupi, një person është gjuajtur aty dhe personi ka
9 vdekur në vendin ku është gjetur, por pas një periudhe kohore
10 trupi është zhvendosur, a mendoni ju se koha mes vdekjes dhe
11 zhvendosjes së trupit domosdoshmërisht rezulton në më pak
12 hemorragji dhe do të ketë domosdoshmërisht më pak njolla gjaku
13 pas trupit?

14 PË. Varet se si zhvendoset. Një trup sigurisht që ka
15 hemorragji pas vdekjes, nuk ka dyshim për këtë. Ka vrima në
16 lëkurë, ka njolla gjaku në trup. Por kjo nuk përshkruhet në
17 asnjë vend në raport.

18 PY. Me kalimin e kohës, a nuk ka më pak njolla gjaku, më pak
19 gjurmë gjaku?

20 PË. Jo domosdoshmërisht. Jo kaq shpejt. Ne këtu po flasim për
21 -- po të flisnim - më falni - për javë e muaj do ndryshonte
22 situata, por është ende trupi, kufoma është e freskët

23 PY. A është po ashtu e mundshme që trupat të jenë
24 transportuar në një mënyrë të tillë që të mos ketë lejuar
25 gjakderdhjen, për shembull, me një automjet ose të kenë qenë

1 të mbështjellë me një material të caktuar?

2 PË. Po. Dhe kjo është e mundshme, po.

3 PY. Edhe trupat thjesht mund t'i kenë vendosur në rrugë kinse
4 trupi, personi është vrarë në vendin që është gjetur?

5 PË. Po, është edhe kjo e mundshme.

6 PY. Edhe gjithashtu nuk jeni në gjendje të na flisni sesi ka
7 mundësi që nuk ka asnjë plumb në trupat e të vdekurve apo në
8 vendngjarje, a nuk mund të ketë qenë kjo një vendngjarje e
9 sajuar dhe kjo të ketë ndikuar në përfundimet e profesor
10 Dobricanin?

11 PË. Po. Nuk ka pasur -- ka pasur gëzhoja në vendngjarje po jo
12 plumba.

13 Dhe ju thashë që shumica e trupave kanë pikë hyrëse dhe
14 pikë dalëse dhe rrjedhimisht që do kenë dalë nga trupi.

15 Logjikisht, duhet të gjendeshin plumba në vendngjarje. Kjo nuk
16 është e zbardhur, nuk është thënë asgjëkundi, por fakti që ka
17 shumë gëzhoja, gëzhoja afër të bën të mendosh, të shtyn të
18 mendosh që gjuajtjet kanë ndodhur në vendngjarje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

20 Alagendra, bëni pyetje të tjera sepse këtë e mbuloi gjerësisht
21 znj. Rowan.

22 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Unë në fakt do të doja të
23 flisja nëse kjo vendngjarje mund të ketë qenë e sajuar, e
24 krijuar.

25 PY. Dr. Clark, A pajtoheni ju me mua që vendi i krimit, pra,

1 vendngjarja të jetë krijuar qëllimisht për të dalë në këto
2 përfundime?

3 PË. Po.

4 PY. Tani, Doktor, kur interpretuat raportin e Dobricanin ju
5 vutë re që disa nga plagët janë shkaktuar nga e njëjta armë në
6 shumës apo në njëjës?

7 PË. Ju thashë "mund", e theksova "mund".

8 PY. Ju po spekuloni për këtë, apo jo?

9 PË. Të gjitha këto plagë, sipas meje, kanë ndodhur me shumë
10 shpejtësi, ka qenë një shpejtësi e madhe. Mund të kenë ndodhur
11 me mitraloz, për shembull, të kishte qenë pistoletë apo
12 revolver plumbi nuk do kishte dalë nga trupi. Është përdorur
13 një armë që është shumë e shpejtë, pra, ka qenë një armë që
14 është shumë e shpejt sepse kjo duket pak edhe nga gjurma,
15 shenja e plagës të pikës hyrëse që tregon që ka qenë armë
16 shumë e shpejt.

17 PY. Po ju nuk keni parë asnjë raport balistike ku konfirmohet
18 lloji i armës që është përdorur?

19 PË. Jo, aspak. Prandaj do të kishte qenë e dobishme të paktën
20 të gjenim plumbat të kishim mundësi që t'i analizonim.

21 PY. Sa i takon personit të parë, që përmendet në faqen 6 të
22 raportit tuaj dhe në përgjigje të pyetjes 5, ju thoni se meqë
23 plagët ishin në pjesën e sipërme të krahërorit, ka të ngjarë
24 që personi të ketë qenë në këmbë në ato momente?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe sa i takon një personi tjetër që përmendet në faqen 9
2 dhe 10 të raportit tuaj, sërish në faqen 10 ju shpreheni se
3 nuk janë gjetur plumba, nuk janë nxjerrë plumba nga trupi, nuk
4 janë gjetur plumba nga trupi i tij?

5 PË. Po, në faqen 9 të raportit.

6 PY. Po në faqen 9 është personi për të cilin po flasim dhe ju
7 në faqen 10 keni thënë që nuk janë nxjerrë plumba nga trupi i
8 këtij personi.

9 Tani pyetja ime është kjo: Nëse një viktimë është
10 detyruar të shtrihet përpara se ta gjuajnë, është shumë e
11 ngjashme që të nxirreshin plumbat nga trupi, apo jo?

12 PË. Plumbi duhet të ishte shumë pranë trupit, do të ishte
13 poshtë në tokë.

14 PY. Pra, do ishte ose brenda në trup ose jashtë poshtë në
15 tokë?

16 PË. Po. Po ne e dimë që plumbat kanë dalë, plumbat kanë dalë
17 nga trupi se është plaga dalëse, kështu që si rregull plumbat
18 duhet të ishin poshtë trupit.

19 PY. Në raport po ashtu shpreheni se personi që ka gjuajtur në
20 të djathtë dhe para viktimës. Çka do të thotë që ka qenë në
21 këmbë?

22 PË. Po.

23 PY. Doktor, nuk besoj se ua kanë dhënë raportin për të cilin
24 do të flas unë dhe ju do na e thoni këtë gjë.

25 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem shohim në ekran

1 materialin 0188-3494-0188-3591, ju lutem. Dhe do të doja të
2 shfaqim faqen 0188-3501. Në fund të faqes ju lutem.
3 PY. Rreshti i fundit, Dr. Clark, ky është hetim në vendin e
4 ngjarjes, raportit nga hetimi në vendin e ngjarjes për personat
5 për të cilët ju kërkua juve që të bënit komente mbi raportin e
6 autopsisë së tyre. Tani, duke patur parasysh konstatimet
7 tuaja, ju pajtoheni që me këtë pikëpamje, pra, që:

8 "Ka shumë gjasa që viktimat të jenë detyruar të shtrihen
9 në tokë dhe pastaj janë qëlluar."

10 Pajtoheni me faktin që kjo është pak e dyshimtë, apo jo?

11 PË. Natyrisht unë do të kisha përdorur fjalët ka "shumë
12 gjasa", "është e mundur". Por mendoj që është më shumë, ka më
13 shumë gjasa, sipas mendimit tim, që ata ishin në këmbë në
14 fakt.

15 Sepse kur qëllohet një person në dy pika, në pjesën
16 përparme të trupit dhe në pjesën e pasme, do të thotë që trupi
17 është qëlluar dhe është kthyer në anën tjetër pastaj. Pra,
18 duke patur parasysh tërësinë e plagëve dhe nivelin e pjesës së
19 sipërme të trupit, pra, vendndodhjen e pjesës së sipërme të
20 trupit përveç plagës që është në kokë dhe në krahë, se ata ka
21 shumë gjasa që të ishin më shumë në këmbë dhe fakti që krahët,
22 ka patur plagë në krahë që përputhen më shumë me persona që
23 janë në këmbë në momentin që janë qëlluar sesa kur janë të
24 shtrirë në tokë.

25 Pra, që pikëpamja ime dhe mendimi im është që do të thoja

1 që ka më shumë gjasa që ata të ishin në këmbë.

2 PY. Doktor, lidhur me mbetjet skeletore, kam vetëm ca pyetje.

3 Pajtoheni që dallimi mes traumës dhe që ka ndodhur afër kohës

4 së vdekjes dhe ndryshimeve *post-mortem* është i vështirë të

5 bëhet sidomos kur indet e buta mungojnë?

6 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Kjo është bërë, kjo

7 pyetja është bërë nga Mbrojtja e Veselit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

9 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim

10 PY. Besoj që përgjigja juaj ishte po.

11 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtimi u pranua. Kështu që nuk

12 ka nevojë dëshmitari të përgjigjet kësaj pyetjeje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju po i jepni

14 përgjigje një pyetjeje që nuk u lejua.

15 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Do të doja në qoftë se më

16 lejoni që të ribëjë pyetjen sepse është parapyetja për pyetjen

17 time të ardhshme.

18 Mund të më kujtojë Prokurori cila ishte përgjigja e tij?

19 Z. PACE: [Përkthim] Nuk është puna ime që ta bëjë këtë

20 gjë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është punë e

22 juaj, znj. Avokate.

23 ZNJ.S. ALAGENDRA: [Përkthim]

24 PY. Ju pranoni që dëmi *post mortem*, pas vdekjes në kocka nga

25 copëza e ambientit apo zgavrimi mund të dëmtojë shenjat e

1 plagës traumatike. Pajtoheni me këtë?

2 PË. Nuk janë shumë faktorët e mjedisit apo të prishjes. Ata
3 lënë shenja tjera dalluese të ndryshme. Ajo për të cilën po
4 flas unë është në traumën pas vdekjes është lëvizja e trupit,
5 lëvizja fizike nga makineri apo ndonjë gjë tjetër që ka
6 shkaktuar këtë plagë. Pra, nuk është çështje ambienti,
7 faktorët e ambientit apo kafshët. Është më shumë gjë fizike.

8 PY. Çfarë lloj dëmi mund të dëmtojë apo të krijojë një plagë,
9 përshtypjen e një plagë traumatike në kohë të caktuara?

10 PË. Çfarë lloj dëmi?

11 PY. Çfarë lloj dëmi jo traumatik që u shkaktohet mbetjeve
12 skeletore? E kam fjalën mund të ngatërrohemi me këto, mund të
13 jenë të ngjashme?

14 PË. Për shembull, trupi që zhvarroset pas shumë vitesh dhe
15 kockat janë të dëmtuara gjatë marrjes së skeletit, zakonisht
16 dallohen që janë shkaktuar në atë moment dhe ka paraqitje të
17 ndryshme. Mund të them, mund të dalloj nëse një kockë apo një
18 eshtër është dëmtuar nga një kafshë, për shembull, sepse ka
19 paraqitje të jashtme karakteristike. Harrova të them, pra, ka
20 tipare karakteristike dalluese.

21 Nuk është gjithmonë e lehtë të dallohet që një frakturë
22 në kockë apo në eshtër është shkaktuar gjatë jetës apo pas
23 vdekjes. Nuk është 100 për qind e sigurtë të bëhet ky dallim.

24 PY. Kam një pyetje tjetër të përgjithshme. A pajtoheni me mua
25 se anti-koagulantët jepet nga doktorët për sëmundjet e zemrës?

1 PË. Për disa sëmundje të zemrës, për shembull, kur ka rrahje
2 të parregullta të zemrës jepen nga doktori këto ilaçe.

3 PY. A pajtoheni me mua që holluesit e gjakut mund të
4 shkaktojnë që mavijosjet të krijohen më lehtë, pra?

5 PË. Po.

6 PY. Dr. Clark, lidhur me individin në faqen 24, 25 të
7 raportit tuaj, kam ca pyetje lidhur me këtë. Pyetja ime ka të
8 bëjë me raportin e autopsisë që mungon, nuk është. Dimë që
9 autopsia është bërë ndoshta rreth datës 2 mars nga Dr. Suzana
10 Matejic. E shihni këtë?

11 PË. Po.

12 PY. A e dinit ju që raporti i autopsisë është nënshkruar
13 pastaj nga i njëjti dëshmitar i mbrojtjes së Milosevic që
14 ishte profesorë Dobricenin?

15 PË. Nuk e dija këtë gjë.

16 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] A mund të shfaqim në ekran
17 dokumentin SPOE00078233-SPOE00078234, faqja 2.

18 PY. Ky është një shënim i përpiluar nga një oficer i EULEX-it
19 i cili raporton mbi përpjekjet për të gjetur raportin e
20 autopsisë që mungonte. Siç mund ta shihni, oficeri i EULEX-it
21 nuk ka arritur ta gjejë këtë raport por ka shënuar, konstatuar
22 aty, kjo është në paragrafin e dytë në fund se shënimet në
23 administratë tregojnë që "raporti është nënshkruar nga Slavisa
24 Dobricanin". E shihni këtë?

25 PË. Po.

1 PY. Tani, që të konfirmojmë, Dr. Clark, juve nuk ju është
2 dhënë ky dokument?

3 PË. Jo.

4 PY. Dhe në faqen 24 konstatooni që shkak i vdekjes është
5 renditur aty, shënuar si "vrasje" e qëllimshme, pastaj ju
6 shënoni që, shënoni aty që:

7 "... vrasja e qëllimshme nuk është shkak vdekjeje, por më
8 shumë mënyra për t'u vërtetuar të tjerëve". Dhe ju thoni
9 gjithashtu që:

10 "Shumë patologë mund të kenë -- nuk do të kishin arritur
11 në të -- nuk janë përfshirë në pjesën 1."

12 Tani, a pajtoheni me mua, z. Clark, që kjo qasje nuk
13 është vetëm në kundërshtim me standardet ndërkombëtare por
14 mund të sugjerojë edhe një anshmëri potenciale të mundshme
15 lidhur me mënyrën, me shkakun e vdekjes siç përsëritur aty dhe
16 karakterizuar aty? Pajtoheni?

17 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Nuk është punë e
18 ekspertit të mjekësisë ligjore që është si dëshmitar këtu që
19 të vlerësojë anshmërinë apo jo, mund të bëjë komente mbi
20 procedurën, po jo lidhur me këtë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
22 Mund t'i përgjigjet pyetjes.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Mund ta përsërisni pyetjen?

24 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

25 PY. Pra, pyetja ime është në faqen 24 ju shënoni që shkak i

1 vdekjes është renditur aty si vrasje e qëllimshme, në thonjëza
2 "vrasje" dhe ju shpjegoni që:

3 "... vrasja nuk është shkaku i vdekjes, por më shumë
4 mënyra që duhet të vërtetohet për të tjerët."

5 PË. Po.

6 PY. Dhe që:

7 "Shumë patologë nuk do ta kishin përfshirë këtë term në
8 pjesën 1C."

9 Pyetja ime është a pajtoheni që kjo qasje është në
10 kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe sugjeron një
11 anshmëri të mundshme lidhur me shkakun e vdekjes siç cilësuar
12 aty?

13 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj që ky dokument të
14 pranohet si provë dhe që t'i jepet një numër prove materiale.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace?

16 Z. PACE: [Përkthim] Unë mendoj që është e gabuar që është
17 edhe pjesë e provave të renditura aty, por natyrisht nuk kemi
18 kundërshtim për pranimin e tij.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sipas
20 standardeve tona do t'i jap një numër provizor dhe të vendos
21 mbi të më vonë.

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin e
23 provës provizore 4D00103 dhe klasifikohet si konfidencial.

24 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Mund të shfaqim në ekran
25 dokumentin SPOE00078351 deri në SPOE00078351. Është vetëm një

1 faqe.

2 PY. Dr. Clark, ky është një raport tjetër i EULEX-it që ka të
3 bëjë me përpjekjet për të gjetur raportin e autopsisë që
4 mungonte lidhur me këtë individ. E shikoni në ekran?

5 PË. Po.

6 PY. Tani në paragrafin 3 të këtij dokumenti lexon:

7 "Në diagnozën relative (numri i protokollit 145,
8 02.03.1999) deklaroi se viktimi kishte të kaluar mjekësore me
9 zemër të zgjeruar."

10 E shikoni këtë?

11 PË. Po.

12 PY. A mund të konfirmoni që ky dokument nuk ju është dhënë
13 juve nga ZPS-ja?

14 PË. E konfirmoj, nuk më është dhënë.

15 PY. A mund të më konfirmoni po ashtu që ky informacion lidhur
16 me sëmundjen e zemrës së këtij individ nuk është përmendur në
17 certifikatën e vdekjes?

18 PË. E saktë. Nuk është aty fare.

19 PY. Dhe a pajtoheni me mua që në rastet kur kemi zmadhim të
20 zemrës probleme kardiake që gjinden bashkë me shenjat e
21 traumës, kjo do të jetë kyçe për të vlerësuar nëse sëmundja e
22 zemrës për shkak të kësaj mund të -- apo ndonjë sëmundje
23 tjetër e zemrës paraekzistuese mund të ketë qenë shkak i
24 parësor kryesor i vdekjes dhe jo trauma në vetvete si shkak i
25 drejtpërdrejtë?

1 PË. Mund të jetë shkak kryesor apo shkak që ka kontribuar në
2 këtë. Dhe certifikata e vdekjes është diçka që në të cilën
3 mund të shënohen shkaqe të mundshme që kanë kontribuar në
4 vdekje, në pjesën 2 të certifikatës së vdekjes. Pra, përveç
5 kësaj nëse shihet e dobishme, e nevojshme për të ndihmuar,
6 shënohen këto lëndime në pjesën 2. Pra, do të ishte e drejtë
7 që të vlerësohet dhe të përfshihet në qoftë se është e
8 nevojshme.

9 PY. Dhe a është e vërtetë që zemra e zmadhuar, në fakt, mund
10 të shtojë rrezikun e ndalimit të zemrës edhe pa patur trauma
11 të shkaktuara nga jashtë?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe pajtoheni me mua që po të kishit patur këtë
14 informacion, pikëpamjet tuaja lidhur me gjasat e vdekjes,
15 mundësitë e vdekjes, se kush ka shkaktuar vdekjen do kishin
16 qenë ndryshe?

17 PË. Do ta kisha marrë këtë në kontekst plagët që kanë qenë të
18 pranishme dhe po t'i kisha vlerësuar si pashmangshmërisht
19 fatale në vetvete do t'i kisha dhënë më shumë -- më pak
20 rëndësi sëmundjes së zemrës. Por ndoshta në qoftë se plagët
21 ishin më pak të mëdha që mund të mos ishin fatale dhe personi
22 ka vdekur dhe që ka patur sëmundje zemre, ndoshta do të kisha
23 përfshirë sëmundjen e zemrës, gjithashtu edhe atë.

24 PY. Por përfundimisht është një informacion që do duhej t'ju
25 ishte dhënë ju me qëllim që të bënit një vlerësim sa më të

1 saktë dhe të tërësishëm të këtij rasti në veçanti --

2 PË. Tani --

3 PY. -- apo jo?

4 PË. -- nuk duhet të bëjë komentime në atë që duhet të më
5 ishte dhënë unë flas për atë që më është dhënë.

6 PY. Në rregull.

7 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj dorëzimin e këtij
8 dokumenti si provë dhe që t'i jepet një numër prove.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
10 kundërshtim?

11 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është një
13 faqe e vetme.

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument merr numrin
15 provizor 4D00104 dhe klasifikohet si konfidencial.

16 Faleminderit.

17 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Ndonjë pyetje nga Prokuroria?

20 Z. PACE: [Përkthim] Po kam ca pyetje.

21 Pyetje vijuese nga z. Pace:

22 Z. PACE: [Përkthim]

23 PY. Mirëdita, Dr. Clark. Gjatë pyetjeve të parashtruara nga
24 Mbrojtja e z. Veseli, u pyetët për disa pika, çështje që keni
25 ngritur lidhur me raportet e autopsisë për pesë viktimat me të

1 cilat -- siç i keni trajtuar në raportin tuaj.

2 Z. PACE: [Përkthim] Po i referohen për ata që janë në
3 Gjykatë, procesverbalit të faqes 2485 të transkriptit të
4 djeshëm.

5 PY. Në pyetjet e mia dje, lidhur me dy prej këtyre pesë
6 viktimave, ju dëshmuat që pavarësisht shqetësimeve tuaja
7 lidhur me trajektoren e disa të shtënave, viktima e parë
8 megjithatë ka vdekur nga një e shtënë me armë zjarri e
9 drejtpërdrejtë nga plaga e shkaktuar në gjoks dhe dyta nga
10 disa të shtëna me armë zjarri.

11 Pyetja ime është: A është ky informacion në dispozicion
12 tuajin, a është kjo e saktë bazuar në informacionin që keni
13 ju?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe lidhur me raportin e ekspertit për të cilin folëm sot
16 dhe dje, lidhur me pesë viktimat, ju deklaroni:

17 "Gjetjet e autopsisë në këto pesë meshkuj janë të gjitha
18 të ngjashme. Ata, secili prej tyre ka vdekur nga plagët e
19 shkaktuara nga armë zjarri dhe pjesa më e madhe e të shtënave
20 në pjesën e sipërme të trupit, në krahë dhe kryesisht në
21 pjesën përballë dhe përparme apo në pjesën anash trupit. Vetëm
22 personi që është qëlluar në kokë dhe gjoks, vetëm një është
23 qëlluar në pjesën e pasme të shpinës dhe përpara dhe asnjëri
24 nuk është qëlluar në pjesët e poshtme, gjymtyrët e poshtme.
25 Cilado qoftë vendndodhja e këtyre të shtënave në trup ... këta

1 kanë vdekur së shpejti.”

2 Dhe pyetja ime është: A është kjo e saktë, bazuar në
3 informacionin që keni?

4 PË. Po.

5 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
7 Barthe.

8 Pyetje nga Trupi Gjykses:

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita. Dhe Trupi Gjykses
10 ka dhe disa pyetje për të kuptuar më mirë, më qartë disa nga
11 pikat që keni mbi të cilat keni dhënë dëshmi.

12 A mund t’i lutemi Sekretarit të Gjykatës që të shfaqë në
13 ekran provën materiale P1991. Faleminderit.

14 Dr. Clark, siç e shihni ky është raporti juaj i
15 patologjisë mjekësi ligjore.

16 Mund të kalojmë në faqen 3. Pak më poshtë.

17 Në këtë faqe, Dr. Clark, duke u përgjigjur pyetjes 9 të
18 Prokurorisë, ju përshkruanit termin *rigor mortis* si një nga
19 katër ndryshimet fizike klasike në trupin e njeriut pas
20 vdekjes që do të thotë ngurtësimi i muskujve që shkaktohet nga
21 një reagim kimik i veçantë. Gjithashtu ju përshkruani që
22 ngurtësimi fillon zakonisht katër orë pas vdekjes dhe i gjithë
23 trupi ngurtësohet rreth pas 12 orësh, pak a shumë. Pastaj
24 ngurtësimi vazhdon deri në procesin e dekompozimit, pra,
25 kalbëzimit gjë që fillon përafërsisht rreth 24 orë 48 orë pas

1 në kushte mesatare normale pas vdekjes.

2 Kjo është përmbledhja e saktë?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime është: Në qoftë
5 se dikush vdes, le të themi në një dhomë apo ndërtesë pa ajër
6 të kondicionuar në mes të verës, një ditë jashtëzakonisht e
7 nxehtë apo e ftohtë, kur fillon procesi i kalbëzimit pak a
8 shumë? Pas 24 orësh apo më herët?

9 PË. Kalbëzimi apo dekompozimi fillon në kohën e vdekjes në
10 fakt, por paraqitja e jashtme ndryshon, apo ndryshimet të
11 dukshme fillojnë zakonisht në kushte normale, siç thashë, mes
12 24-48 orë më vonë. Ndryshimet e para shihen që janë ndryshimi
13 i ngjyrës, trupi merr një ngjyrë si gjelbër, në pjesën e
14 barkut, pra, lëkura mbi barkun dhe pastaj vazhdon kalbëzimi,
15 bakteret të cilat gjenden në zorrë fillojnë të tresin indet e
16 buta të trupit pas vdekjes dhe pastaj ndryshimet e para në
17 pjesën e abdomenit shpërndahe.

18 Megjithëse procesi fillon menjëherë, paraqitja ajo bëhet
19 e dukshme mesatarisht 48 orë apo 24-48 orë më vonë. Siç e
20 thashë, në kushtet e ngrohta temperatura të larta, dekompozimi
21 fillon, pra, shenjat janë të qarta brenda pak orësh. Në
22 kushtet në të kundërt, në kushte të ftohta, kjo mund të zgjasë
23 edhe një javë, domethënë, që momentin ku shihen ndryshimet.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në shembullin
25 tim, shembulli sapo ju dhashë kur është afati më i vonshëm kur

1 mund të fillojë kalbëzimi?

2 PË. Më kujtohet që ju përmendët në kushte standarde ku ka
3 ajër të kondicionuar, nuk është as nxehtë as ftohtë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ka ajër të kondicionuar,
5 nuk është ftohtë, nuk është jashtëzakonisht nxehtë, nuk është
6 jashtëzakonisht ftohtë.

7 PË. Do të thoja që fillon brenda dy, tre orësh [Sipas
8 përkthimit], fillohen të shihen shenjat e para.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe cilat
10 pjesë, kjo është pjesa e trupit [E pakuptueshme] e trupit
11 ngurtësohet së pari dhe cila -- dhe ku përfundon pastaj?

12 PË. Fillimisht muskujt e vegjël të trupit dhe pastaj ndoshta
13 gishtat dhe pastaj gradualisht vazhdon të përfshijë pjesë,
14 grupet e muskujve më të gjerë siç janë gjymtyrët, trupi e
15 tjerë.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe në pikat, në përgjithësi
17 ngurtësimi zhduket -- kur zhduket ky ngurtësim?

18 PË. Mund të qëndrojë në një fazë të tillë për tre katër ditë
19 derisa të fillojë procesi i kalbëzimit dhe të shpërndalet.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nëse ju kuptoj saktë, ju
21 thatë dje që *livor mortus* apo lividiteti, që ju e quajtet më
22 parë, ndodhë varësisht nga pozicioni të cilin personi ka
23 vdekur apo jo?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, në qoftë se një person

1 vdes në një pozicion të ulur, kur mendoni që fillon

2 lividiteti?

3 PË. Për shkak të gravitetit, shkon tek këmbët, pastaj pjesa e
4 pasme e kofshëve sepse personi është i ulur në karrige, pjesa
5 e pasme e shpinës. Kjo kështu shpërndalet.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam një pyetje lidhur me
7 paragrafin 9 të shënimit përgatitor të ZPS-së. S'ka nevojë të
8 shfaqet në ekran.

9 Bazuar në këtë paragraf, ju keni deklaruar se termat
10 ekzaminimi "*post mortem*" dhe "*autopsia post mortem*" është e
11 njëjta gjë për ju. Ju kujtohet kjo?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini, Dr. Clark, se në
14 disa vende si, për shembull, Gjermania këto dy terma kanë
15 kuptim të ndryshëm në fakt dhe në ligj, i pari do të thotë
16 thjesht inspektimi, shikimi i kufomës së personit të vdekur
17 nga jashtë, ndërsa e dyta do i referohet një ekzaminimi të
18 pjesës së brendshme të trupit nga doktorë? A jeni i njohur me
19 këtë?

20 PË. E pranoj këtë. Unë po flisja në terma të përgjithshëm
21 laikë. Por e kuptoj që po thoni dhe e pranoj.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Mund të jetë edhe
23 çështje përkthimi.

24 Tani, shkurtimisht në një çështje që lidhet me këtë që ka
25 të bëjë me përkthimin, Mbrojtja ju pyeti -- në fakt dy ekipe

1 të Mbrojtjes ju pyetën për termin "vrasje" dhe ju thanë që nuk
2 përputhej me standardet ndërkombëtare dhe që mund të jetë një
3 shenjë paanshmërie. Ju kujtohet kjo?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dr. Clark, në qoftë se
6 shikoni në versionin në origjinal raportit të autopsisë në
7 versionin serbisht, a keni kontrolluar këtë fjalën "vrasje" në
8 anglisht, nëse fjala do të thoshte vrasje në anglisht, fjala e
9 përdorur në serbisht?

10 PË. Jo, unë jam bazuar tek përkthimi në anglisht.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dje ju treguan fotografi të
12 personit të vdekur nga Prokuroria dhe kjo u trajtua dhe nga
13 Mbrojtja sot.

14 Për nevoja të procesverbalit i referohem provës materiale
15 P858, faqja 4 dhe në vijim.

16 Ju kujtohet Dr. Clark, që i keni diskutuar këto
17 fotografi?

18 PË. Bëhet fjalë për personin e ulur në karrige?

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po.

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nëse ky person, po të ishte
22 parë ky person gjallë 24 orë përpara që të bëheshin këto
23 fotografi, a do të ishte kjo në mospërputhje me vlerësimin
24 tuaj për kohën e mundshme të vdekjes që ju e vlerësuat disa
25 orë ose një, dy ditë më parë?

1 PË. Jo. Ajo që thoni është në përputhje me konstatimet që kam
2 bërë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Vlerësimi juaj një ose dy
4 ditë lidhur me mavijosjet që ju përshkruat si relativisht të
5 freskëta - në faqen 46 të transkriptit - a përputhet kjo me
6 atë që sapo ju përshkrova unë? Pra, që po të supozojmë që
7 sikur personi të ishte parë i padëmtuar 24 orë përpara, a do
8 ta vlerësoni që kjo ka ndodhur më herët?

9 PË. Po. Këto mund të jenë edhe thjesht të bëra, të shkaktuara
10 pak orë përpara vdekjes.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

12 Sot në mëngjes, në faqen 54 të transkriptit ju thatë që
13 plagët e jashtme që patë ju në personin në fotografi nuk ishin
14 të vogla dhe thatë që mund të supozohet, është mundësi që ai
15 mund të ketë vdekur nga një sulm në zemër që është shtuar nga
16 stresi i plagëve të marra dhe ju thatë që është e vërtetë që
17 një person mund të vdesë në çdo kohë nga një sëmundje zemre?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nga pikëpamja juaj si doktor
20 ekspert, a është e mundur, ka gjasa që një person 70-vjeçar me
21 sëmundje kardiovaskulare në një -- i lidhur në një karrige dhe
22 që ka patur plagë, siç i keni parë në fotografi, të mund të
23 vdiste për shkaqe që janë të paralidhura me këto rrethana, me
24 fjalë të tjera, që t'ju jap thjesht nga një sulm në zemër që
25 mund të ndodhë në çdo kohë?

1 PË. Mua, mendoj, që është ka pak gjasa të ketë qenë kështu.
2 Mendoj se mundësitë janë që nuk ishte thjesht koincidencë,
3 pra, që plagët kanë me shumë gjasë luajtur një rol në vdekjen
4 e tij.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do kaloj në një temë tjetër.

6 Z. Sekretar, na kaloni në seancë private për shkaqe të
7 mbrojtjes së dëshmitarit dhe personave të tjerë.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

15 jemi në seancë publike.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mirëdita, Dr. Clark.

17 PË. Mirëdita.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua të filloj pyetjen lidhur

19 me pikat hyrëse dhe pikat dalëse. Në qoftë se keni një trup që

20 ka disa pika hyrëse dhe dalëse të plumbit sa e rëndësishme

21 është që të korrespondojnë plagët e hyrjes me ato të daljes

22 për të arritur në përfundimin që viktimja ka vdekur si rezultat

23 i plumbave të shtënë drejt tij?

24 PË. Nuk është thelbësore sepse mund të ndodhë që plumbi të

25 dëmtojë organet e brendshme. Mund të jetë e dobishme ose mund

1 të ndihmojë në qoftë se ti bën korrespondonim e pikës hyrëse
2 me atë dalëse, po nuk është e domosdoshme.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sipas ekspertizës tuaj,
4 sipas përvojës tuaj profesionale, a është praktikë e
5 përgjithshme për një autopsi, për një raport autopsie që të
6 korrespondojë plagë të ndryshme të hyrjes me plagë dalëse të
7 plumbit në rastin e dëmtimeve të shkaktuara si rezultat i disa
8 plumbave të presuara për të mbërritur në përfundimin që
9 viktimi ka vdekur si rezultat i lëndimeve nga të shtënat me
10 armë?

11 PË. Mendoj se patologu duhet që të përpigëj sa më shumë të
12 jetë e mundur që të bëjë përshkrimin e lëndimeve ose që të
13 bëjë përkimin e këtyre lëndimeve në pikat hyrëse dhe dalëse.
14 Por në qoftë se ka dyshime, duhet që këto dyshime të mund të
15 thuhën qartazi.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua tani që të kalojmë tek
17 çështja e pranisë së plumbave tërësisht ose në fragmente të
18 tyre në trupin e personit të vdekur.

19 Mbi bazën e përvojës tuaj dhe duke qenë që keni këqyrur
20 shumë raste të tilla në Bosnjë, në Kroaci, në Kosovë madje dhe
21 gjetkë, a mund të na thoni sesa mundësi ka që të gjenden
22 pjesëza të plumbave ose vetë plumba të plotë në trupin e
23 personit dhe që këto plumba të kenë kaluar përmes trupit të
24 personit?

25 PË. Është shumë e zakonshme. Unë kam në pjesën dërrmuese të

1 çështjeve ose të rasteve që unë kam trajtuar në Bosnjë, ne
2 kemi gjetur të paktën një pjesëz, një fragment të plumbit në
3 trup. Jo në të gjitha rastet, por në pjesën dërrmuese të
4 rasteve. Në qoftë se bëhet fjalë për municion me shpejtësi të
5 lartë, domethënë, ideja kryesore e këtij municioni është që ta
6 përshkruajë trupin, domethënë, të futet në një pikë dhe të
7 dalë nga ana tjetër e trupit. Por në qoftë se plumbi haset me
8 një kockë, me një eshtër, zakonisht tendenca është që të lihet
9 një lloj fragmenti ose një lloj pjesëze e plumbit dhe madje
10 edhe pjesëza të tjera që mund të dalin nga ana tjetër.

11 Pra, mendoj që është e zakonit që të gjenden fragmente
12 ose pjesëza të plumbave në trupa, madje ndonjëherë domethënë,
13 mund të gjinden edhe i gjithë plumbi në vetvete.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani do të flasim për
15 rëndësinë e gjetjes së plumbit nga trupi.

16 Edhe dua të pyes në qoftë se gjetja e një plumbi të
17 ndihmon për përcaktimin se plumbi është gjuajtur në drejtim të
18 personit të caktuar nga një armë e caktuar, por, në fakt, nuk
19 ka domosdoshmërisht rëndësi për sa i takon arsyet së vdekjes së
20 viktimës, domethënë, që viktimë ka vdekur nga një armë zjarri?
21 PË. Po.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani do të kalojmë tek
23 trajektoret. A është e vërtetë, a është e drejtë që gjetja e
24 një plumbi nga një mur ose një pajisje ose mobileje që mund të
25 ketë qenë në vendin e krimit të ndihmon për të përcaktuar

1 trajektoren e plumbit e cila nga ana e vet të ndihmon për
2 përcaktimin e vendit se ku është gjuajtur personi?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani që përcaktua që
5 trajektorja e plumbit përmes trupit gjithashtu mund të
6 ndihmojë për përcaktimin e vendit ku ka qenë personi kur
7 gjetur, a nuk është kështu, Dëshmitar?

8 PË. Po, kështu është.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa e rëndësishme është që të
10 gjendet një plumb ose një fragment i plumbit në mënyrë të
11 tillë që të përcaktohet që personi ka vdekur për shkak të
12 gjuajtjeve me armë zjarri?

13 PË. Nuk është e domosdoshme. Lëndimi me armë zjarri njihet,
14 është lehtësisht i identifikueshëm, kështu që ne mund të
15 identifikojmë hyrjen, pikën hyrëse të plumbit, pra, mund të
16 identifikojmë gjithashtu edhe plagën e shkaktuar dhe është
17 lëndim i cili në fakt mund të konstatohet edhe pa gjetjen e
18 plumbit ose madje edhe të fragmenti ose pjesëze të tij. Pra,
19 nuk është e domosdoshme kjo.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në qoftë se kemi të bëjmë me
21 disa lëndime të krijuara si rezultat i të shtënave me armë, sa
22 e rëndësishme është që të vërtetohet trajektorja precize ose e
23 saktë e plumbave që kanë kaluar, kanë përshkruar trupin për të
24 përcaktuar se personi ka vdekur nga lëndimi me armë, nga
25 gjuajtjet me armë zjarri?

1 PË. Është e rëndësishme të përcaktohet që plumbi ka dëmtuar
2 organet jetike. Për shembull, një plumb i cili kalon nga pjesa
3 e pasme e krahut dhe, në përgjithësi, domethënë, në qoftë se
4 të gjuan dikush në krahë, nuk shkaktohet vdekja e personit.
5 Megjithatë është e rëndësishme që të jesh në gjendje që të
6 vërtetojë që plumbi ka shkaktuar dëmtime, për shembull, në
7 organet jetike si, për shembull, në zemër, në arteriet e
8 gjakut, në mushkëri apo në organe të tjera të cilat janë
9 jetike siç e thashë dhe më përpara, në mënyrë të tillë që të
10 vërtetojmë shkakun e vdekjes për këtë arsye.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në qoftë se bëhet fjalë për
12 një pikë të vetme hyrëse dhe në qoftë se bëhet fjalë për
13 plagën në pikën dalëse, sa e rëndësishme është që të
14 përcaktohet trajektorja në mënyrë të tillë që të thuhet që
15 personi ka vdekur për shkak të armës së zjarrit?

16 PË. Mendoj se përgjigja është në një prej këtyre -- në
17 përgjigjen time të fundit mund ta gjeni atë çfarë është
18 shpjegimi. Pra, duhet që të cekë strukturën vitale të trupit
19 në mënyrë të tillë që të shkaktohet vdekje prej armës së
20 zjarrit.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani për ta përmbledhur, ju
22 lutem na sqaroni në qoftë se e kam kuptuar siç duhet apo jo,
23 që në qoftë se nuk përpigjen që të përcaktohet vendndodhja e
24 personit që gjuan me plumb, atëherë as trajektorja dhe as
25 plumbi në vetvete nuk është se ka rëndësi thelbësore për

1 përcaktimin në qoftë se personi ka vdekur si rezultat i armëve
2 të zjarrit apo jo?

3 PË. [Nuk ka përkthim].

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka pyetje
5 të tjera nga palët?

6 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes asnjëri nuk kanë pyetje.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E vlerësojmë
8 shumë faktin që ishit me ne, Dëshmitar. Faleminderit. Ju
9 urojmë gjithë të mirat. Dhe faleminderit për të gjitha
10 sqarimet e dhëna.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit juve.

12 [Dëshmitari largohet]

13 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam dy
15 çështje përpara sesa të bëjmë pushimin besoj.

16 Së pari, kam diçka për të thënë lidhur me ofrimin e
17 dokumenteve nga kolegu im për sa i takon pranimit të tyre në
18 prova gjyqësore. Ne i kërkojmë Trupi Gjykses që të na japë
19 neve të njëjtën sasi ditësh ose kohe siç është dhënë edhe në
20 rastin e profesor Goodwin, domethënë, kërkojmë që të kemi kohë
21 deri të mërkurën e ardhshme që t'i përgjigjemi.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Së pari, unë
23 pajtohem që Prokuroria të më japë një listë të dokumenteve që
24 ka kërkuar që t'i caktohet një numër provizor prove.

25 Edhe juve keni disa dokumente të cilat kanë caktuar si

1 numra provizor provash. Edhe këtë kërkon që të regjistrohen?

2 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Jo, neve do kërkojmë që këto
3 dokumente të pranohen si prova gjyqësore vetëm në qoftë se
4 Prokuroria vendos që të pranohen si prova gjyqësore, vetëm në
5 atë rast.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

7 Z. PACE: [Përkthim] Sa për ta sqaruar, të nderuar
8 Gjykatës, ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres. Neve kemi kërkuar
9 në Shtojcën 1 të shënimit përgatitor se cilat janë dokumentet
10 që kërkojnë që të pranohen si prova gjyqësore.

11 Mbrojtja e Veselit thotë që do kërkojë që të pranohen
12 dokumentet e tyre vetëm në qoftë se ne kërkojmë dokumentin,
13 pranimin eventual të dokumenteve të tyre, kështu?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
15 atëherë. Ju kërkuat që të përgjigjeshit deri të mërkurën, apo
16 jo?

17 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

19 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Së dyti, të nderuar Gjykatës, ju
20 dy herë na keni kërkuar si Ekipë Mbrojtje që të na thoni se
21 cili është qëndrimi jonë sa i takon pyetjeve të bëra.
22 Gjithashtu, ne do ju kërkonim juve që t'i kërkonit Prokurorisë
23 që të deklarojë se cili është qëndrimi i tyre ose cilat janë
24 provat e tyre paraprakisht që t'i përgjigjemi mocionit për
25 pranim. Pra, Prokuroria po kërkon që të pranohet në provë

1 autopsia për sa i takon vërtetësisë së përmbajtjes së tij dhe
2 të mbështetet në të që deklaron që shkaku i vdekjes është i
3 pasigurt, i papërcaktuar.

4 Nga ana tjetër dëshmitari thotë, "Unë mund t'ju jap juve
5 shkakun e vdekjes. Kam ardhur në përfundimin tim që është
6 përfundim i veçantë". Por kjo nuk mund të lejohet. Kjo nuk
7 mund të jetë e vërtetë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ishte më
9 mirë në fakt që ta parashtroji në argumentet tuaja se kemi
10 raste të tjera që duhet të trajtojmë.

11 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e vlerësoj
12 shumë nevojën për të nxituar, por vështirësia këtu është që
13 Mbrojtja nuk e di se cili është qëndrimi i Prokurorisë.

14 Vështirësia është që ne nuk mund të bëjmë dot një
15 parashtim.

16 Pra, edhe një herë ne nuk mund t'i përgjigjemi argumentit
17 për pranueshmërinë kur nuk e dimë në qoftë se raporti i
18 autopsisë do ofrohet për t'u paraqitur si provë gjyqësore për
19 sa i takon vërtetësisë së tij. Kështu që për këtë arsye është
20 e rëndësishme që Prokuroria të thotë se cili është qëndrimi i
21 sak që të kemi nevojë që ne pastaj të japim përgjigjen
22 përkatëse.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pace.

24 Z. PACE: [Përkthim] Megjithëse argumentet që sapo dëgjuam
25 kanë të bëjnë me autopsitë edhe provat e dëshmitarëve, të

1 nderuar Gjykatës, e keni trajtuar këtë gjë, domethënë, ka
2 pasur raste, parashtrimi identike të cilat janë trajtuar prej
3 jush dhe ju keni vendosur në të shkuarën që kjo kërkesë e
4 Mbrojtjes për të dhënë qëndrimin tonë është rrëzuar dhe e
5 njëjta gjë do të duhet që të bëhet edhe tani.

6 Në qoftë se dëshirojnë Ekipet e Mbrojtjes mund të japin
7 argumentet e tyre në të dyja rastet, po apo jo dhe nuk është e
8 nevojshme që të rishpikim rrotën këtu për sa i takon kësaj
9 kërkesë të Prokurorisë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do e mbyllim
11 këtu këtë diskutim. Prokuroria mund të ofrojë dokumentet për
12 pranime gjyqësore me shkrim. Ju duhet t'i përgjigjeni të
13 mërkurën.

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kam edhe diçka tjetër, i nderuar
15 Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E thashë
17 qartë mendoj? E mbyllëm këtë diskutim. Ju jepni parashtrimet
18 tuaja. Vendimet do t'i marrim ne. Prokuroria do bëjë kërkesat
19 e veta. Atëherë ne do përdorim rregullën 138, siç bëjmë
20 gjithmonë dhe do përdorim gjithashtu edhe rregullën që ka të
21 bëjë me aktekspertizat prej dëshmitarëve në lidhje me këtë dhe
22 kaq, mbaroj ky diskutim.

23 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Kam një temë tjetër që dua
24 të ngre, nëse më lejoni?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë

1 pushim deri në orën 2.00. Do fillojmë në orën 2.00 dhe

2 shpresojmë që do përfundojmë sot me dëshmitarin.

3 Znj. Alagendra, më thoni.

4 Z. PACE: [Përkthim] Unë dua të pyes që do vijojmë siç

5 bëme me ekspertin e fundit, pra, ku do dorëzojmë së pari

6 përgjigjet e Mbrojtjes, apo jo?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 Z. PACE: [Përkthim] Po kërkoj qartësim sa i takon

9 kalendarit për sa i takon parashtrimeve lidhur me këtë

10 dëshmitar. Me z. Goodwin Mbrojtja dorëzoi parashtrimet e veta

11 një herë dhe pastaj u përgjigjëm ne.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një herë dua

13 të shikoj dokumentet tuaja, çfarë kërkon ju që të pranohet.

14 Pastaj Mbrojtja do japë përgjigjet e veta.

15 Z. PACE: [Përkthim] E kuptoj.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se

17 dorëzimi i dokumentit do të bëhet prej Mbrojtjes të mërkurën,

18 atëherë ju do të keni mundësi që të kundërpërgjigjeni deri të

19 premtën.

20 Z. PACE: [Përkthim] E kuptoj. A mund të vendosni që të

21 bëhet parashtrimi deri në orën 4.00 të mërkurën?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Deri në fund

23 të ditës.

24 Znj. Rowan, e kuptuat?

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Flas anglisht, kështu që e

1 kuptova.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
3 Znj. Alagendra.

4 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam
5 një çështje që është ngritur nga Gjykatësi Barthe, që u
6 konfirmua përkthimi në serbisht është i saktë dhe dua të them
7 që në përkthimin në serbisht thuhet që është fjala "vrasje".

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
9 Tani do ta mbyllim. Do bëjmë pushim deri në orën 2.00.

10 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.49

11 --- Seanca rifillon në orën 14.03

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Meqë doli si
13 problem Prokuroria si pala thirrëse, duhet të verifikojë me
14 Njësitë -- Njësinë e Përkthimit për fjalën "ubijaka" [Sipas
15 përkthimit] të verifikojë kuptimin e gjuhës në serbisht, të
16 verifikohet kuptimi i kësaj fjale ju lutem.

17 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Po, do ta bëjmë këtë gjë me
18 Njësinë për Përkthimin.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Okej.
20 Fillojmë me dëshminë e dëshmitarit -- dëshminë, më falni,
21 dëshminë Dëshmitarit të Prokurorisë W02586.

22 Ju lutem, silleni dëshmitarin në sallë.

23 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, a
25 na dëgjoni? Mirëdita, Doktor. Do t'ju lexoj tekstin e betimit

1 solemn, të cilin duhet ta bëni në përputhje me Rregulloren e
2 Gjykatës, paragrafi 5 i rregullës 149 [Sipas përkthimit]. Ju
3 lutem, përsërisni pas meje.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky është
6 betimi: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime -- pra,
7 i ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe
8 përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them
9 të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk
10 do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

11 Pajtoheni me betimin solemn?

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

13 DËSHMITARI: HELMUT SCHRECKENBAUER

14 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
16 uleni.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dr.

19 Schreckenbauer, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që
20 mendohet se do të zgjasë më pak se një ditë. Sikurse mund ta
21 dini në fillim i bën pyetjet Prokuroria. Pasi të përfundojë
22 Prokuroria ekipet e Mbrojtjes kanë të drejtë t'ju bëjnë
23 pyetje, por mund t'ju bëjnë pyetje edhe Gjykatësit.

24 Prokuroria ka kërkuar një orë për pyetjet e veta. Ekipet
25 e Mbrojtjes ka kërkuar po ashtu rreth një orë. Inkurajoj palët

1 të jenë sa më të kujdesshme në shfrytëzimin e kohës. Trupi
2 Gjykues mund të lejojë pyetje plotësuese nëse përmbushen
3 kushtet përkatëse.

4 Dëshmitar, përgjigjuni qartë, me fjali të shkurtra. Nëse
5 nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni që pyetja të
6 përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që ta
7 sqarojmë.

8 Gjithashtu, na thoni ku i bazoni ju faktet, rrethanat për
9 të cilat do t'ju bëjmë pyetje.

10 Në qoftë se Prokuroria ju kërkon të përmendni korrigjimet
11 që i keni bërë deklaratës suaj, duhet të thoni me zë për
12 procesverbal se deklarata me shkrim bashkë me korrigjimet
13 përkatëse pasqyron saktësisht dëshminë tuaj.

14 Gjithashtu, flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë
15 sekonda përpara se të përgjigjeni. Si dhe flisni ngadalë për
16 përkthyesit.

17 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit, nuk
18 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë tuaj
19 jashtë sallës së gjyqit. Nëse ndonjë person jashtë ambienteve
20 të Gjykatës ju bën pyetje për dëshminë tuaj, na njoftoni
21 menjëherë.

22 Ju lutem, ndërprisni fjalën nëse jua kërkohet unë dhe ju
23 lutem mos flisni më nëse unë ngre dorën, sepse unë do të duhet
24 të jap një udhëzim.

25 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na njoftoni dhe

1 do të bëjmë organizimin përkatës.

2 Fillojmë tani me pyetjet nga Prokuroria që është ulur në
3 të majtën tuaj. Ju lutem dëgjojeni me vëmendje.

4 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

5 Pyetje nga znj. Insinga:

6 ZNJ. INSINGA: [Përkthim]

7 PY. Mirëdita, Doktor.

8 PY. Mirëdita.

9 PY. Jemi takuar edhe më herët, po do prezantohem edhe një
10 herë. Quhem Alexandra Insinga. Do t'i bëj unë pyetjet në emër
11 të Prokurorisë. Sikurse jua shpjegoja në takimin që patëm, nuk
12 do t'ju bëj pyetje për çdo aspekt të mundshëm për të cilin
13 mund të keni informacion. Ekziston dhe mundësia që të pranohen
14 deklarata tuaja të mëparshme si pjesë e provave gjyqësore në
15 të cilat gjendet ky informacion.

16 Sidoqoftë do të duhet të ndjekim disa hapa për këtë.

17 Fillimisht na thoni emrin dhe mbiemrin.

18 PË. Quhem, Dr. Helmut Schreckenbauer.

19 PY. Datëlindja dhe vendlindja?

20 PË. Kam lindur më 23 mars 1968 në Traunstein.

21 PY. Çfarë profesioni keni?

22 PË. Jam mjek i specializuar në mjekësinë e organeve të
23 brendshme.

24 PY. Çfarë pozite keni aktualisht, çfarë titulli? Çfarë grade?

25 PË. Jam rreshter me gradë ushtrie dhe jam shef i divizionit

1 të gastrologjisë në një spital.

2 PY. Doktor, çfarë grade dhe titulli keni pasur në qershor
3 1999?

4 PË. Në 1999 kam qenë -- kam qenë mjek, po me titull ushtrie,
5 po nuk e kisha përfunduar ende specializimin atëherë. Në atë
6 kohë isha i specializuar -- po specializohesha për mjekësi.

7 PY. Ju kujtohet që keni -- keni dhënë një intervistë
8 Prokurorisë më herët?

9 PË. Po, më kujtohet kjo.

10 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të nxjerrë
11 në ekran materialin 071408-TR Part 1 Revised 2 RED në
12 gjermanisht, si dhe anglishten në 071408-TR-ET Pjesa 1 Revised
13 2 RED. Faleminderit.

14 PY. Doktor, në faqen përpara jush është pjesë e një
15 intervistës që keni dhënë për ZPS-në. A është kjo një pjesë e
16 intervistës që keni dhënë për ZPS-në në vitin 2019?

17 PË. Po.

18 PY. A ju kujtohet që e keni deklaruar këtë deklaratë përpara
19 takimit tonë, pra këtë javë?

20 PË. Më kujtohet, po.

21 PY. A ju kujtohet që patët mundësi t'i bënit disa sqarime
22 kësaj deklarate?

23 PË. Saktë.

24 PY. A ju kujtohet që këto shënime u hodhën në një dokument
25 dhe u lexuan në gjuhën tuaj nga një përkthyes?

1 PË. Po.

2 PY. Duke marrë parasysh tani dhe korrigjimet që bëtë ju në
3 fillim të kësaj jave, informacion në deklaratën tuaj mesa keni
4 ju dijeni dhe besoni ju, a është i saktë dhe i vërtetë?

5 PË. Siç m'u tregua mua të hënën, po.

6 PY. Nëse përfshijmë të gjithë korrigjimet dhe sqarimet që
7 keni bërë ju këtë javë, deklarata juaj e pasqyron saktësisht
8 atë që do të thonit ju sot nëse do t'ju bënim pyetje për të
9 njëjta ngjarje që hedhur në këtë deklaratë apo që janë
10 përshirë në këtë deklaratë?

11 PË. Po.

12 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pasi
13 përmbushëm kriteret e rregullës 154, dhe në përputhje me
14 vendimin F02720, kërkojmë pranimin e deklaratës së mëhershme
15 të dëshmitarit si dhe Shënimin Përgatitor numër 1 dhe provave
16 materiale shoqëruese. Materialet, ERN-të përkatëse si për
17 deklaratën dhe për provat materiale shoqëruese, mund të
18 gjendjen në dokumentin që mban numrin F02720, por mund tua
19 lexoj nëse e gjykoni të nevojshme.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është
21 nevoja për momentin.

22 Keni kundërshtime?

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kemi asnjë kundërshtim
24 ndryshe nga kundërshtimet e mëhershme.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Edhe ne të njëjtat kundërshtime që

1 kemi shprehur tashmë në dokumentin përkatëse.

2 Z. TULLY: [Përkthim] E njëjta gjë për ne.

3 Z. BAIESU: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me
5 numrin 071408-TR, të treja pjesët pranohen, përfshirë këtu
6 anglishten dhe gjermanishten.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ne kemi dhe shqipen. Kam
8 nevojë për një sqarim.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Pjesa 1 do
11 të marrë numrin e provës P01994.1, Pjesa 2, .2, dhe Pjesa 3,
12 .3 për të tria gjuhët dhe klasifikimi është konfidencial.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi dhe
14 Shënimin Përgatitor numër 1 edhe provat materiale shoqëruese
15 të cilat po ashtu janë të pranuar.a

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Shënimi Përgatitor me
17 numër 1, me ERN 124730-124733, do të marrë numrin e provës
18 P01995 dhe klasifikimi është konfidencial.

19 Provat materiale shoqëruese me ERN 017394 [Sipas
20 përkthimit] deri në 017297 [Sipas përkthimit] dhe përkthimi në
21 anglisht, do të marrin numrin e provës P01996, dhe klasifikimi
22 është konfidencial.

23 ERN-ja SITF00189402 deri në SITF00189426-ET dhe
24 veçanërisht faqet SITF00189408 deri në SITF0000189409 [në
25 anglisht dhe gjermanisht do të marrin numrin e provës P01998

1 dhe klasifikimi është konfidencial.

2 ERN-ja SITF00189430 deri në SITF00189430 - në anglisht
3 dhe gjermanisht - sidoqoftë për gjermanishten vetëm faqja
4 SITF00189430 - do të marrë numrin e provës 0199 [Sipas
5 përkthimit] dhe klasifikimi është konfidencial.

6 Prova e fundit me numër SITF00189465, deri në
7 SITF00189484 nga e cila vetëm faqja SITF00189482 në anglisht
8 dhe në gjermanisht, do të marrë numrin e provës P02000 dhe
9 klasifikimi është konfidencial. Faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Verifikoje
11 një herë numrin, ju lutem, sepse nuk pashë dokumentin me 1997.

12 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Po, është e drejtë. Në fakt
13 është prova e dytë shoqëruese. E lexuat gabim numrin.

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Është
15 faji im për këtë. Edhe një herë pra.

16 Dokumenti me ERN SITF00189342 deri në SITF00189362, faqja
17 SITF00189348, si në anglisht dhe në gjermanisht do të marri
18 numrin e provës P01997 dhe klasifikimi është konfidencial.
19 Faleminderit.

20 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Faleminderit.

21 Për sa i takon klasifikimit, deklaratat dhe shënimi
22 përgatitor mund të kenë klasifikimin publik, ndërsa prova
23 materiale shoqëruese duhet të mbeten kontekst

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
25 Do ta marrim parasysht.

1 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Më 21 janar 2025, ZPS-ja dorëzoi
2 një përmbledhje për këtë dëshmitar, që tashmë është pranuar
3 sipas rregullës 154. Nuk kemi marrë asnjë kundërshtim dhe me
4 lejen tuaj do të doja ta lexoja këtë përmbledhje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

6 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Dr. Shreckenbauer është mjek i
7 ushtrisë gjermane i cili ka qenë i dislokuar me KFOR-in në
8 Kosovë nga qershori deri në gusht 1999 dhe ka qenë i
9 stacionuar në zonën e Prizrenit. Ai ka qenë i pranishëm me 18
10 qershor 1999 kur KFOR-i bastisi ish-goditën e MUP-it në
11 Prizren, ku trajtoi disa nga personat e ndaluar atje që ishin
12 të lënduar, dhe përgatiti raportin *post-mortem* për personin e
13 vdekur që u gjet në ndërtesë.

14 PY. Doktor, ju lutem, na shpjegoni, a punoni ju aktualisht
15 dhe ku punoni?

16 PË. Po, punoj në spitalin e ushtrisë së Republikës Federale
17 Gjermane në Ulm.

18 PY. Sa kohë keni që punoni atje?

19 PË. Kam punuar në spitalin në Ulm që prej 1996. Kam pas disa
20 shkëputje në fakt, por atje fillova menjëherë pasi përfundova
21 studimet.

22 PY. Doktor, a mund të na shpjegoni nivelin tuaj të arsimit?

23 PË. Pasi përfundova shkollën e mesme në 1988, fillova -- u
24 kyça në ushtrinë federale për një kohë të caktuar. Në atë kohë
25 kam kryer 15 muaj shërbimin ushtarak. Në tetor 1989 fillova

1 studimet për mjekësi dhe mbarova studimet në 1996.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem znj.
3 Prokurore, bëni një pauzë të shkurtër mes pyetjeve dhe
4 përgjigjeve.

5 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

6 Edhe gjithashtu mund të hiqen edhe deklaratat nga ekrani.

7 PY. Doktor, ju thatë që i përfunduat studimet në 1996. Në
8 këtë momente u konsideruat për herë të parë mjek, e morët
9 titullin mjek?

10 PË. Po. Kjo është hera e parë kur unë u konsiderova si mjek,
11 mora titullin si mjek.

12 PY. Në deklaratën për ZPS-në keni përshkruar disa nga detyrat
13 dhe përgjegjësitë që keni pasur në Kosovë nga qershori në
14 gusht 1999, ndër të cilat kryesisht ju ofronit mjekësor
15 forcave ushtarake gjermane.

16 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Për procesverbal ky dokument
17 tashmë ka marrë numrin P01194.1, është faqja 7 në të dyja
18 gjuhët.

19 PY. Doktor, kur shkuat në Kosovë, kishit ndonjë përgjegjësi
20 tjetër ju përveçse kujdesit mjekësor për forcat gjermane?

21 PË. Kur mbërrita në vendin ku më dislokuan detyra ime
22 kryesore ishte të kujdesesha për forcat e ushtrisë gjermane.

23 PY. Kur mbërritët atje ju mësuar në fakt që përveç kësaj ju
24 kishit dhe përgjegjësi të tjera, apo jo?

25 PË. Jo fillimisht, jo sapo kisha mbërritur, por me kalimin e

1 kohës dolën dhe detyra të reja, kisha detyra të reja.

2 PY. A mund të na e përshkruani cilat detyra ishin këto?

3 PË. Shkuam, na thërrisnin në raste aksidentesh ku kishte

4 civilë, apo ku kishte automjete civile dhe ushtarake, na

5 thërrisnin në raste sëmundjesh kur kishte të sëmurë tek

6 popullata civile, sepse në ato momente nuk kishte spitale apo

7 struktura shëndetësore në terren shkurtimisht pasi shkuam ne

8 në Kosovë. Më pas shkonim edhe në raste vdekjesh për të

9 përcaktuar shkaqet e vdekjes.

10 PY. Përveç jush, sa persona të tjerë kishte me përvojë

11 mjekësore në këtë mision nga ana gjermane?

12 PË. Sa i takon grupit tim ishin dy të tjerë, po ashtu

13 përgjegjës për trupat gjermanë. Ka qenë një kirurg, kam qenë

14 unë, kemi pasur edhe infermierë që kishin përvojë në fushën e

15 mjekësisë. Ndërsa në pjesët e tjera kishte mjekë edhe grupet e

16 tjera kishin mjekë. Pra, nuk kam qenë unë i vetmi mjek në

17 terren atje.

18 PË. Pra, disa nga përgjegjësitetë që kishit ju, ishte edhe të

19 përgatisni dokumentacione, për shembull, si raporte *post-*

20 *mortem*, pas vdekjes. Përafërsisht sa raporte *post-mortem*

21 kishit kryer ju përpara se të shkonit në misionin në Kosovë?

22 PË. Përpara se të shkoja në Kosovë unë kisha punuar tre vjet

23 si mjek dhe mendoj se mund të kem bërë rreth -- mund të kem

24 përgatitur rreth 20 raporte ekzaminuese *post-mortem*, pas

25 vdekjes.

1 PY. Me përafërsi sa raporte *post-mortem* keni përgatitur ju që
2 pas misionit në Kosovë në karrierën tuaj?

3 PY. Unë kam punuar si mjek për 29 vjet tashmë, nëse e
4 llogarita siç duhet. Ka 29 vjet që jam mjek tanimë. Kështu që
5 mund të kem përgatitur me qindra.

6 PY. Krahas raporteve *post-mortem* a keni përgatitur ju
7 dokumente të tjera, si për shembull, certifikata vdekje gjatë
8 kohës që keni qenë në Kosovë?

9 PË. Nuk e kuptoj dot tani dallimin mes një raporti *post-*
10 *mortem* dhe certifikate vdekje. Është e njëjta gjë.

11 PY. Në rregull. Në praktikën tuaj të përgjithshme jashtë
12 Kosovës këto dy terma a kanë kuptim të ndryshëm?

13 PË. Jo. Në Gjermani ka certifikatë vdekje. Formulari apo
14 shablloni në vetvete, po është e njëjta gjë.

15 PY. Kur thoni "forma" e keni fjalën për dokumentin që
16 plotësoni?

17 PË. Po. Kur kemi lëshuar deklaratata apo dokumente të tilla për
18 herë të parë në Kosovë ne nuk kishim një shabllon, nuk kishim
19 ndonjë formular fiks. Ne përdornim fillimisht një bllok
20 mjekësh ku shkruanim të dhënat. Më vonë u përgatit një
21 formular me simbolin e NATO-s. Në Gjermani i kemi standarde
22 formularët që përdorim në këto raste.

23 PY. Në deklaratën tuaj të mëparshme keni përshtuar momentin
24 kur shkuat tek godina e MUP-it në Prizren më 18 qershor 1999
25 dhe ndihmuat nga pikëpamja mjekësore disa persona të lënduar.

1 A ju kujtohet gjendja psikologjike e personave që kenë

2 trajtuar?

3 PË. Jo në hollësi. Jo në hollësi. Nuk ishin plagë që

4 kërcënonin jetën. Ishin të zgjuar. Mundëm të bisedonim me ta.

5 Natyrisht ata ishin pak të irrituar, të stresuar për shkak të

6 faktit që ishin të plagosur, të lënduar, por nuk më kujtohet

7 diçka konkrete për gjendjen e tyre mendore.

8 PY. A mund të përshkruani plagë të tjera ashtu siç ju

9 kujtohen?

10 PË. Po. Disa prej tyre kishin plagë që dukeshin si therje me

11 thikë apo me objekte të tjera të mprehta në kofshë, në krahë.

12 Kishin prerje në kokë dhe plagë që dukeshin si goditje të

13 shkaktuara nga goditje, kishin mavijosje në pjesën e barkut

14 apo të abdomenit apo edhe të gjoksit.

15 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] I kërkoj Sekretares që të shfaqë

16 në ekran dokumentin P01188.1.

17 Dhe ndërsa presim që të shfaqet në ekran, të qartësojmë

18 për procesverbal që numri i provës materiale për këtë

19 deklaratë e thashë gabimisht. Thashë rreshti 14, në rreshtin

20 14, mendoj që është T107 dhe unë thashë P01194.1. Numri i

21 provës materiale i saktë është P0994.1.

22 Faleminderit. Zmadhojmë fotografinë.

23 PY. Doktor, a njihni dikën në këtë fotografi apo ndonjë gjë?

24 PË. Shoh tre nga personat e plagosur, të lënduar. Shoh një

25 ushtar i cili po i jep trajtim mjekësor, po mat tensionin të

1 një personi, shoh dhe çantën me pajisjet mjekësore anash që
2 është e hapur. Tani a jam unë personi që është me uniformë në
3 pjesën e pasme, nuk mund ta them, në sfond aty, nuk mund të
4 them që jam unë.

5 PY. Doktor, që të jemi të qartë në procesverbal, ju thatë që
6 shihni tre persona të lënduar. Për çfarë situatë e keni
7 fjalën, kujt i referoheni?

8 PË. Ky ishte trajtimi i parë mjekësor që kemi bërë kur kemi
9 arritur në vendngjarje dhe gjetëm këta persona jashtë
10 ndërtesës të lënduar.

11 PY. Vendngjarja, është vendngjarja jashtë ndërtesës së MUP-it
12 në Prizren ku ju keni ndërhyrë, apo jo?

13 PË. Po. Ky është vendi përballë ndërtesës së MUP-it.

14 PY. Doktor, përshkruat individët që duket që po marrin ndihmë
15 -- që po i japin ndihmë mjekësore personave të lënduar në atë
16 kohë ju -- tani a ju kujtohet sot emri i personit aty që po
17 jep ndihmë mjekësore?

18 PË. Jo, nuk më kujtohet emri i këtij personi, fatkeqësisht,
19 jo.

20 PY. Doktor, dua tani t'ju bëj disa pyetje lidhur me personin
21 e gjetur të vdekur në ndërtesë. Nuk do ta shfaqim për publikun
22 asnjë fotografi dhe nuk do të përmendim emrin e këtij personi.

23 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Z. Sekretar i Gjykatës, a mund
24 të shfaqni në ekran P00858, kalojmë në faqen 7 të provës
25 materiale që është SITF00189127. Është faqja 7. Dhe nuk duhet

1 që të shihet nga publiku. Faleminderit.

2 PY. Doktor, fotografia që është në ekran përpara jush, a
3 është kështu siç ju kujtohet juve që e keni gjetur personin e
4 vdekur?

5 PË. Po kështu.

6 PY. Do shikojmë disa fotografi të tilla, por në këtë
7 fotografi që po shohim tani a mund të përshkruani disa nga
8 lëndimet që keni vërejtur në këtë fotografi?

9 PË. Në këtë fotografi mund të shohim një mavijosje në gjoks
10 të personit, sepse personi është akoma i veshur.

11 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Nëse Sekretari tani mund të
12 kaloj në faqen 6 të kësaj prove materiale. Faleminderit.

13 PY. Doktor, në këtë fotografi, a mund të përshkruani ju lutem
14 lëndimet që keni vërejtur, konstatuar tek ky individ?

15 PË. Personi i vdekur është apo është vendosur në pozicion me
16 barkë poshtë, këmisha është hequr. Mund të shohim lividitetin
17 *post-mortem* në pjesën e poshtme të trupit të sipërm dhe në
18 pjesën e sipërme shihen lëndime, plagë, që duken si traumë e
19 shkaktuar nga një goditje me send të fuqishëm.

20 PY. Ka ndonjë gjë të veçantë që ju e keni parë tek ky individ
21 lidhur me mavijosjet, diçka të veçantë?

22 PË. Është e vështirë, gjithmonë e vështirë për të përcaktuar
23 se çfarë është mavijosje dhe çfarë është lividitet *post-*
24 *mortem*, duket që mavijosjet janë pak më të vjetra dhe ndoshta
25 janë me gjasë janë shkaktuar personit gjatë kohës që personi

1 ishte akoma gjallë.

2 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kërkoj të shfaqim në ekran një
3 provë tjetër materiale tani që është pranuar si P01996. Dhe
4 kalojmë në faqen P071395. Është faqja 2. Faleminderit.

5 PY. Doktor, kjo është një fotografi tjetër e të njëjtës pjesë
6 të trupit të individit për të cilin po flisnim. A jeni në
7 gjendje të bëni ndonjë koment të thoni diçka lidhur me
8 mavijosjet që shihen në këtë fotografi?

9 PË. Mavijosjet janë ngjyrë e kuqe e errët në pjesën e sipërme
10 të trupit dhe më poshtë në pjesën e poshtme të trupit. Unë do
11 të interpretoja këtë si livididet *post-mortem*. Përndryshe
12 personi ka të veshur vetëm mbathjet, pra, nuk ka pantallona
13 tani.

14 PY. Doktor, në deklaratën tuaj dhënë ZPS-së kemi diskutuar
15 disa nga sendet që janë gjetur në këtë ndërtesë, i keni
16 përshkruar ato si "instrumente torture".

17 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Për procesverbal, kjo është në
18 P01994.2, në faqen 53.

19 PY. Doktor, a jeni në gjendje të thoni nëse ndonjë nga plagët
20 apo lëndimet që keni parë, konstatuar tek personi i vdekur
21 është, përputhet me sendet që keni gjetur në ndërtesë?

22 PË. Fatkeqësisht, nuk e shoh fotografinë me sendet. Nuk e di
23 nëse doni që unë t'ju them atë që më kujtohet nga ajo
24 fotografi, por tani në ekran nuk e shoh këtë fotografi.

25 PY. Do t'i kërkoj Sekretarit që ta nxjerrë në ekran këtë

1 fotografi.

2 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Z. Sekretar, na nxirrni në ekran
3 ju lutem P01179, faqja U002-4994. Faleminderit.

4 PY. Doktor, a është kjo fotografia që për të cilën e kishit
5 fjalën të sendeve në ndërtesë?

6 PË. Kjo është në fakt fotografia që më është treguar.

7 PY. Doktor, a jeni në gjendje të na thoni nëse ndonjëri prej
8 sendeve në këtë fotografi është, përputhet me plagët që keni
9 konstatuar tek i vdekuri?

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kundërshtim. Ne mendojmë që kjo
11 është jashtë fushës së ekspertizës. Mekanizmi i plagosjes
12 është mekanizëm për patologun vetëm. Ky dëshmitar nuk është
13 ekspert patolog dhe nuk mund të jap mendimin e tij për
14 mekanizmin e plagosjes.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
16 Vazhdoni.

17 ZNJ. INSINGA: [Përkthim]

18 PY. Mund t'i përgjigjeni pyetjes. A doni që ta përsëris?

19 PË. Nuk keni nevojë ta përsërisni. Tani, është e mundur që
20 këto shkopinj druri apo instrumente apo metalike të mund të
21 jenë përdorur për të shkaktuar këto lëndime.

22 PY. A ka ndonjë gjë në mavijosjet që shihen në fotografinë e
23 të vdekurit që mund t'ju bëjë juve të thoni që është e mundur
24 të ketë qenë kështu?

25 PË. Ne kishim plagë të zgjatura, që mund të jenë shkaktuar

1 nga këta shkopinj apo sende që janë përdorur për të goditur.

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Prokuroria po e thërret këtë
3 dëshmitar si dëshmitar për faktet apo si ekspert mjekësor që
4 duhet të japë mendimin e tij? Duhet ta kuptojmë më qartë?

5 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Dëshmitari po jep dëshmi si
6 dëshmitar për fakte bazuar në konstatimet që ka bërë në vendin
7 e ngjarjes dhe që po përshkruan në dëshminë e tij.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Faleminderit.

10 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Kërkoj ndjesë që po ndërpres. Por
11 duke pasur parasysh konstatimet që ka bërë dhe komentet e tij,
12 kundërshtimi jonë i fundit qëndron, sepse ky dëshmitar nuk
13 është nuk po thirret si ekspert dhe nuk mund të japë mendimin
14 e tij.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
16 Vazhdoni.

17 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Faleminderit.

18 PY. Doktor, këto ishin të gjitha pyetjet që kisha unë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

22 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Baiesu, e
24 shoh që jeni po bëheni gati. Mund të vazhdoni.

25 Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu:

- 1 Z. BAIESU: [Përkthim]
- 2 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Unë përfaqësoj z. Krasniqi.
- 3 PË. Mirëdita.
- 4 PY. Ju keni shkuar në Kosovë si pjesë e forcave të KFOR-it me
5 ose rreth datës 12 qershor 1999, është kështu?
- 6 PË. Nuk më kujtohet data e saktë, po rreth asaj date, po.
- 7 PY. Ju ishit doktor në ushtri, në trupat ushtarake, pjesë e
8 trupave ushtarake, saktë?
- 9 PË. Po.
- 10 PY. Dhe keni qëndruar në Kosovë deri më 10 gusht 1999, saktë?
- 11 PË. Pak a shumë kështu është e saktë.
- 12 PY. Ju i shpjeguat Prokurorisë që përgjegjësia juaj kryesore
13 dhe e parë ishte që t'i ofronit trajtim dhe përkujdesje
14 mjekësore ushtrisë gjermane pjesë e KFOR-it, saktë?
- 15 PË. Po, kjo ishte detyra jonë parësore.
- 16 PY. Gjithashtu, keni shpërndarë ilaçe, medikamente popullsisë
17 vendore por nuk keni ofruar, dhënë trajtim mjekësor gjatë
18 patrullave tuaj, saktë?
- 19 PË. Shpërndarja e ilaçeve, medikamenteve popullsisë është
20 diçka që ishte e mundur dhe ishte bërë në marrëveshje me
21 udhëheqësin e patrullës, është diçka që kemi bërë gjatë
22 patrullimeve tona.
- 23 PY. Në fakt, doktorët nuk janë pjesë e këtyre patrullimeve,
24 por për shkak që ushtarët tuaj ishin me shëndet dhe mirë, ju
25 keni qenë në gjendje që të kishit mundësi që të ishit pjesë e

1 këtyre patrullimeve, apo jo?

2 PË. Po, është e saktë. Ne ishim dy, njëri prej doktorëve
3 ishte vazhdimisht në çdo çast në gjendje që të përkujdesej për
4 ushtarët tanë, ndërsa tjetri shkonte pjesë e patrullës. Por
5 përndryshe, nuk do të kishte qenë e mundur.

6 PY. Dhe ju nuk keni patur kontakte me UÇK-në dhe nuk kishit
7 ndonjë njohuri, nuk dinit ndonjë gjë për ushtarët e UÇK-së apo
8 komandantë të UÇK-së?

9 PË. Personalisht nuk kam pasur asnjë kontakt me njerëzit e
10 UÇK-së apo njerëzit të lidhur me UÇK-në.

11 PY. Në Fakultetin e Mjekësisë keni bërë vetëm kursin e
12 përgjithshëm të mjekësisë mjeko-ligjore, saktë?

13 PË. Saktë.

14 PY. Dhe pak përpara që të fillonit misionin tuaj në Kosovë në
15 1999, keni bërë përgatitjet ushtarake, por kjo nuk ishte e
16 përqendruar në trajtimin mjekësor, a është e saktë?

17 PË. Përgatitja për këtë dislokim, për këtë mision ishte
18 përgatitje ushtarake, por jo mjekësore.

19 PY. Dhe keni filluar të jeni bërë pjesë e ushtrisë përpara se
20 të mbaronit specializimin tuaj në mjekësi, saktë?

21 PË. Saktë. Dhe kjo ka qenë mënyra e rregullt, normale për të
22 bërë këtë gjë, sepse studimet për mjekësi bëhen brenda
23 kornizës -- janë bërë si pjesë e kornizës së stërvitjes të
24 përgatitjes sime ushtarake. Kështu bëhej zakonisht.

25 PY. Nuk keni ndonjë stërvitje ose ndonjë trajnim të

1 specializuar për hetime penale apo të mjekësisë ligjore?

2 PË. Saktë. Dhe kjo nuk është detyrë e doktorit të
3 përgjithshëm, kjo është pjesë e -- kjo është detyrë e forcave
4 të policisë.

5 PY. A pajtoheni me mua që me qëllim që të jeni në gjendje të
6 jepni një mendim, opinion të besueshëm, të mbështetshëm,
7 lidhur me metodat dhe instrumentet e torturës së përdorur një
8 person duhet të jetë i -- të ketë trajnim të specializuar në
9 analizën mjeko-ligjore të instrumenteve të torturës dhe të
10 efekteve psikologjike dhe fizike që ata shkaktojnë?

11 PË. Për të gjetur, zbuluar shkakun e saktë të vdekjes, do të
12 duhej të ishte bërë një autopsi mjeko-ligjore, por kjo nuk
13 ishte e mundur të bëhej në vendin ku ishim dislokuar.

14 PY. Dhe në universitet dhe pas universitetit ju nuk keni bërë
15 ndonjë stërvitje apo trajnim përgatitje të specializuar për
16 analiza mjeko-ligjore?

17 PË. Jo, nuk kam bërë ndonjë përgatitje, trajnim të
18 specializuar në këtë fushë.

19 PY. Ju jeni doktor në mjekësi me përvojë, a është e vërtetë
20 që studimet dhe analiza mjeko-ligjore e torturës dhe e
21 efekteve të saj kërkon një ekspertizë mjeko-ligjore specifike
22 e cila shpesh shkon përtej studimeve të përgjithshme të
23 mjekësisë?

24 PË. Pas studimeve të mjekësisë apo studimet e mjekësisë
25 përfshijnë trajnim bazë dhe mjekësia mjeko-ligjore është temë

1 -- është lëndë tjetër e specializuar që bëhet pas studimeve të
2 përgjithshme të mjekësisë.

3 PY. Dhe ju nuk keni bërë këtë lëndë apo këtë specializim pas
4 studimeve universitare?

5 PË. Saktë.

6 PY. Duke pasur parasysh që teknikat e torturës mund të
7 ndryshojnë, janë shumë të ndryshme dhe përfshijnë instrumentet
8 kompleks dhe të ndryshëm, a besoni që niveli juaj i
9 ekspertizës ju lejon, ju jep mundësinë juve që në mënyrë
10 bindëse të identifikoni instrumentet e sakta dhe metodat e
11 sakta të përdorura në këtë rast, në rastin për të cilin po
12 flasim?

13 PË. Natyrisht, nuk mund ta bëj këtë gjë. Është thjesht
14 supozim.

15 PY. Faleminderit. Do kaloj tani në një temë tjetër. Në
16 intervistën tuaj, keni thënë që kur keni arritur tek ish-
17 ndërtesa e MUP-it më 18 qershor 1999, nuk ju kujtohet të keni
18 parë ndonjë pjesëtar të UÇK-së jashtë apo brenda ndërtesës, a
19 është kështu?

20 PË. Kështu është saktë. Nuk më kujtohet të kem parë ndonjë
21 prej tyre.

22 PY. Dhe kur keni hyrë brenda në ndërtesën e MUP-it nuk kishte
23 civil brenda. 10 apo 15 civilë që keni parë ishin të
24 grumbulluar jashtë ndërtesës, është kështu?

25 PË. Më duket që më kujtohet kjo. Pastaj ne i kemi lejuar këta

1 persona që të kthehen, të futen përsëri në ndërtesën e MUP-it
2 në mënyrë që të ishim në gjendje t'ju jepnim trajtim mjekësor
3 brenda ndërtesës pa patur kalimtarët që ishin aty.

4 PY. Pyetja ime është kur keni arritur ju aty, kur arritët ju
5 aty ata nuk ishin brenda, ishin jashtë këta persona pra?

6 PË. Më kujtohet që disa prej tyre ishin jashtë. Nuk më
7 kujtohet nëse disa apo disa prej tyre ishin brenda, ishin
8 akoma brenda në atë moment.

9 PY. Pra, nuk ju kujtohet apo nuk jeni në gjendje të
10 konfirmoni që këta civilë ishin brenda ndërtesës dhe, në qoftë
11 se kështu, sa kohë kanë qëndruar ata brenda ndërtesës përpara
12 që KFOR-i të arrinte aty?

13 PË. Më kujtohet vetëm se kishe disa njerëz, persona jashtë
14 ndërtesës, por nuk e di a kishte persona brenda ndërtesës.

15 Z. BAIESU: [Përkthim] Do të përpiqem t'ju rifreskoj
16 kujtesën dhe do kërkoj që të shfaqim në ekran provën materiale
17 P01994.2, faqja 47. Kërkoj ndjesë, 1994.2, faqja 10 fillimisht
18 dhe ngjitur me të, pra, me dokumentin në gjermanisht kërkoj të
19 vendosim faqen 10, pjesën në fund. Dokumenti në gjermanisht
20 pak më poshtë, ju lutem.

21 PY. Tani do t'ju lexoj pjesën përkatëse:

22 "Numri i saktë 10, 15 ishin jashtë ndërtesës, por nuk
23 kishin lëndime që mund të shkaktonin vdekjen."

24 E shikoni këtë?

25 Z. BAIESU: [Përkthim] Në versionin gjermanisht duhet të

1 jetë faqja 10 në fund të faqes 10 duke filluar nga rreshti 22
2 dhe rreshti i parë në faqen vijuese, faqen 11.

3 Dhe në qoftë se mund të kalojmë tek i njëjti dokument në
4 faqen 47 të versionit anglisht, ndërsa në versionin në
5 gjermanisht është faqja 51. Rreshtat 1 deri në rreshtin 5 në
6 versionin gjermanisht.

7 PY. Dhe do ta lexoj. Hetuesi pyetje:

8 "Kur hytë në ndërtesë çfarë patë? A kishte njerëz aty,
9 ishte bosh?"

10 Përgjigje:

11 "Ndërtesa ishte bosh kur ata hynë aty."

12 A është kjo dëshmia juaj?

13 PË. Po, e saktë. Së pari, fillimisht ndërtesa ishte bosh, por
14 kur ne i lejuam të lënduarit që të kthehen sërish në ndërtesë
15 ishte një dhomë e ndarë ku kemi dhënë trajtim mjekësor të
16 lënduarve dhe nuk më kujtohet nëse kur arritëm aty të gjithë
17 të lënduarit ishin jashtë ndërtesës apo ndoshta policia
18 ushtarake i ka lejuar ata që të dalin jashtë ndërtesës. Këtë
19 nuk e di. Me qëllim që t'ju jepnin trajtim atyre i lejuam të
20 hyjnë në ndërtesë sërish.

21 Dhe kur u futëm në ndërtesë bashkë me policinë ushtarake,
22 sepse mora informacionin që në katin e parë të ndërtesës ishte
23 një person i vdekur, në atë moment nuk më kujtohet të ketë
24 patur njerëz të tjerë në ndërtesë.

25 PY. Këta persona të lënduar ishin në gjendje të ecnin vetë,

1 apo jo?

2 PË. E saktë.

3 PY. Më vonë pastaj kur hytë në ndërtesë, ju thoni që keni
4 shikuar brenda, por që nuk keni hyrë në një dhomë ku ju thoni
5 që ishin kishte instrumente torture, saktë?

6 PË. Po, saktë. Kjo ishte në të njëjtin kat ku ishe personi i
7 vdekur. Nuk më kujtohet nëse ishte dhoma ngjitur me të apo dy
8 tre dhoma më larg prej kësaj, por ishte afër dhomës ku personi
9 i vdekur u gjet.

10 PY. Juve nuk është se kontrolluat me hollësi në atë dhomë,
11 apo jo?

12 PË. Po, nuk kontrolluam. Nuk ishte detyra ime kjo. Kjo ishte
13 detyrë e policisë ushtarake.

14 PY. Ju nuk këqyrët fizikisht atë çfarë përshkruani si
15 instrument torture, a është e saktë kjo?

16 PË. Po, është e saktë.

17 PY. Megjithatë ju keni patur mundësi që t'i këqyrnit këto
18 instrumente në qoftë se do të vendosnit që ta bënit këtë punë,
19 apo jo? Vetëm me po ose jo si përgjigje.

20 PË. Mendoj se po.

21 PY. Në qoftë se do të kishit këqyrur ose ekzaminuar këto
22 instrumente, ju do keni pasur mundësi që t'i keni, të thoni
23 se çfarë përmasash kanë pasur instrumente të tilla. A është e
24 saktë kjo?

25 PË. Po t'i kisha parë, do kishte qenë e mundur që të shihja

1 sesa të mesha ishin këto instrumente.

2 PY. Do keni pasur mundësi po t'i kishit parë që të vërtetonit
3 në qoftë se ka pasur gjurmë gjaku ose gjurmë të tjera në
4 secilin prej këtyre instrumenteve, apo jo?

5 PË. Po, është e saktë. Por dua të them dhe një herë që kjo
6 nuk është detyra e mjekut. Është detyrë e policisë ushtarake.

7 PY. Kur ka gjurmë gjaku në një armë që mendohet që të ketë
8 shkaktuar vdekjen e një personi, në veçanti në fotografitë që
9 ju ka treguar Prokuroria, ju besoj se pajtoheni me mua që
10 duhet që të ishin bërë analiza të ADN-së edhe të gjurmëve të
11 gishtave për sa u takon këtyre instrumenteve, apo jo?

12 PË. Po. Por në 1999, mendoj që teknikat ose kërkesa teknike
13 nuk ishin përmbushur për t'u bërë analiza e ADN-së.

14 PY. Megjithatë në çdo rast juve nuk keni përmendur që të jetë
15 bërë ndonjë analizë e ADN-së e këtyre instrumenteve gjatë
16 intervistës, kështu që është e drejtë të thuhet që ju nuk e
17 dini në qoftë se është bërë ndonjë analizë ADN-je për këto
18 instrumente, apo jo?

19 PË. E saktë.

20 PY. Në pjesën 2 të provës P01994.2, faqja 25, rreshtat 18
21 deri në 24 të intervistës tuaj, i keni thënë Prokurorisë si më
22 poshtë:

23 "Unë nuk mund të them me siguri në qoftë se këto plagë
24 janë shkaktuar nga objekte apo jo. Nuk e di as të them se
25 cilat objekte mund të jen përdorur."

1 Ndërkohë që disa rreshta më poshtë ju keni shtuar:

2 "Unë nuk mund të përcaktoja në qoftë se ishin përdorur
3 objekte për këtë apo jo."

4 I qëndroni kësaj dëshmie, Dëshmitar?

5 PË. Nuk mund të jem tërësisht i sigurtë. Sikurse e thashë dhe
6 në fillim ky është një supozim i imi dhe instrumentet e
7 torturës që më janë treguar mua është e mundur që mund ta kenë
8 shkaktuar një lloj lëndimi të tillë.

9 PY. Ky është supozimi jua domethënë, kështu?

10 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] U bë pyetja dhe e mori
11 përgjigjen.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

13 Z. BAIESU: [Përkthim]

14 PY. Të hënën, domethënë, këtë të hënë gjatë seancës
15 përgatitore Prokuroria ju ka treguar fotografi me instrumente
16 që janë gjetur në ndërtesë. A ju kujtohen këtë, Dëshmitar?

17 PË. Po, më janë treguar fotografitë.

18 PY. Përderisa ju nuk i keni ekzaminuar, nuk i keni këqyrur
19 instrumentet vetë personalisht dhe sikurse e keni thënë dhe në
20 intervistën tuaj që dhoma ku ju i keni parë këta individë
21 ishte e errët nuk mund të arrihet në përfundimin që këto
22 instrumente janë përdorur për keqtrajtimin e këtyre
23 individëve, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Keni thënë gjithashtu në intervistën tuaj që as nuk ju

1 kujtohet nëse i keni parë instrumentet, apo jo, në ish-
2 ndërtesën e MUP-it apo në një ndërtesë tjetër. A ju kujtohet
3 ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

4 Z. BAIESU: [Përkthim] Referenca për këtë është prova
5 P1994.2, faqja 54 dhe 55.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk ka të bëjë me faktin që
7 instrumentet mund të kenë qenë në një ndërtesë tjetër, por sa
8 i takon fotografive që më janë treguar mua nuk më kujtohet që
9 t'i kem parë këto objekte ose këto instrumente në këtë dhomën
10 pa dritë ose të errët që më është treguar në fotografi.

11 Z. BAIESU: [Përkthim]

12 PY. Për të vlerësuar në qoftë se këto shenja janë, i përkojnë
13 apo jo ose i takojnë këtyre instrumenteve, do ishte e
14 nevojshme që të bëhet këqyrja fizike dhe forensike e lëndimeve
15 edhe të instrumenteve po ashtu?

16 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kundërshtohet. Është pyetje që u
17 bë dhe e mori përgjigjen.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

19 Z. BAIESU: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, a pajtoheni me mua që nuk është gjithmonë e
21 mundur që të identifikohet një instrument i caktuar që
22 përdoret për torturë ndaj njerëzve mbështetur vetëm në
23 paraqitjen e lëndimit ose mënyra sesi duket plaga?

24 PË. Mendoj që kjo është e saktë, megjithatë unë personalisht
25 nuk jam as patolog dhe nuk jam as shkencëtar forensik.

1 PY. Në rregull. Do të kaloj në një temë tjetër. Gjatë
2 intervistës Prokuroria ju tregoi disa certifikata vdekjeje të
3 përgatitura prej jush në atë kohë. A ju kujtohen këto
4 certifikata, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 PY. Dëshiroj që të shikojmë njërin prej këtyre raporteve në
7 më tepër hollësi.

8 Z. BAIESU: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretarisë
9 të paraqesë n ekran dokumentin SITF00189342 deri në
10 SITF00189362. Do ju lutesha të paraqisnit të dyja versionet,
11 versionin në anglisht dhe në gjermanisht në origjinal, numri
12 ERN është i njëjtë për të dyja versionet, të dyja këto
13 dokumente do kërkoja të paraqiteshin përbri me njëra-tjetrën.

14 PY. Keni qenë i pranishëm në vendin e krimit kur keni bërë
15 këqyrjen mjekësore të personit që përfshihet në këtë raport, a
16 është e saktë kjo, Dëshmitar?

17 PË. Ky është një raport i policisë ushtarake. Mbështetur në
18 këtë raport, unë nuk mund të them me siguri në qoftë se kam
19 qenë aty apo jo. Pra, nuk e di në qoftë se është e njëjta
20 situatë që më kujtohet mua apo jo.

21 Z. BAIESU: [Përkthim] do kërkoj që të kalojmë në faqen 7
22 në versionin në gjermanisht dhe në versionin në anglisht.

23 PY. E shihni emrin tuaj këtu, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. Do t'jua bëj edhe një herë pyetjen atëherë. I takon që ju

1 keni qenë i pranishëm në vendin e krimit kur keni bërë

2 ekzaminimin gjyqësor, kështu, Dëshmitar?

3 PË. Po, është e saktë kjo.

4 Z. BAIESU: [Përkthim] Të kalojmë përsëri në faqen 3 të
5 versionit në PDF të këtij dokumenti në të dyja versionet në
6 anglisht dhe në gjermanisht. Faleminderit.

7 PY. Në paragrafin 3.1, në dëshminë e dëshmitarit, në
8 "Deklaratat e dëshmitarit", thuhet që dëshmitarët të cilët
9 kanë qenë fqinjët e viktimës, kanë raportuar që kanë dëgjuar
10 ca të shtëna armësh por nuk kanë dhënë asnjë informacion
11 tjetër. A e shikoni këtë pjesën, Dëshmitar?

12 PË. Po, e lexoj. E lexoj në këtë raport të policisë
13 ushtarake.

14 Z. BAIESU: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja tjetër. Në
15 faqen 4 në të dy versionet.

16 PY. Në paragrafin 4.3, me titullin "Numri i autorëve të
17 krimit", këtu numri i autorëve të krimit ose kryerësve thuhet
18 "nuk dihet". A e shikon këtë, pra, nuk dihet sesa veta e kanë
19 kryer krimin, e shihni këtë pjesë, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Është shumë e qartë prej këtij raporti që kryesit e
22 veprës nuk janë identifikuar. A pajtoheni me mua?

23 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kundërshtoj. Nuk e di se cila
24 është relevanca e këtyre pyetjeve për këtë dëshmitar.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo shkon

1 përtej fushëveprimit të pyetjeve të bëra nga Prokuroria. Në
2 qoftë se keni qëndrim të caktuar duhet të na e bëni me dije
3 atë dhe pastaj të bëni pyetjet përkatëse.

4 Z. BAIESU: [Përkthim]

5 PY. Qëndrimi është që mbështetur në këtë raport nuk ishte e
6 mundur që të arrihej në përfundimin në qoftë se kryesit
7 vërtetë kanë qenë shqiptarë apo jo.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë
9 relevance ka kjo?

10 Z. BAIESU: [Përkthim] Relevanca është që këto raporte
11 janë kërkuar që të pranohen në prova materiale dhe kryesit e
12 veprave në këto raporte janë persona të pamentifikuar.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
14 [Përkthim] A lidhet kjo me pyetjet e bëra nga Prokuroria?

15 Z. BAIESU: [Përkthim] Personi ka qenë në skenën e krimit,
16 në vendin e krimit kur është bërë kjo këqyrje dhe kur e ka
17 bërë ekzaminimin dhe nuk ka pasur informacion që i është dhënë
18 atij sa i takon kryerësve.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
20 Mund të vazhdoni.

21 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Shumë shkurtimisht më lejoni
22 t'ju them, të nderuar Gjykatës, për procesverbal, që e vetmja
23 faqe e këtij raporti që i është treguar dëshmitarit që i është
24 kërkuar që të pranohet si provë gjyqësore është SITF0018349
25 dhe 348 që nuk është faqja që është në ekran dhe Avokati po i

1 bën pyetje lidhur me këtë dokument që nuk e ka parë
2 dëshmitari.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
4 dokumenti i gabuar ky?

5 Z. BAIESU: [Përkthim] Jo, nuk është dokumenti i gabuar.
6 Dokumenti i plotë ka gjashtë faqe. Është një dokument të cilin
7 e pamë rreth një orë më përpara. Është prova që ka numrin
8 1997. Mund t'jua jap edhe numrin e plotë në qoftë se doni,
9 numrin e plotë të faqeve.

10 Këto pyetje kisha. Megjithatë përpara sesa ta mbyll, a
11 mund ta pyes dhe një herë dëshmitarin të na japi përgjigjen që
12 nuk na e dha?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

14 Z. BAIESU: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, mbështetur në atë çfarë ju patë në këto dy
16 faqe të dokumentit dhe duke u mbështetur vetëm në këtë raport,
17 a pajtoheni me mua që nuk është e mundur që të arrihet në
18 përfundimin që vërtet kryerësit e veprës kanë qenë shqiptarë,
19 apo jo?

20 PË. Kjo s'ka qenë detyra ime si mjek, nuk është që unë të
21 gjej kryerësit e veprës, por puna ime ose detyra ime ishte që
22 të konstatoja që dikush kishte vdekur dhe mesa ishte e mundur
23 të jepja informacion lidhur me shkakun e vdekjes. Unë nuk jam
24 oficer policie, s'kam qenë as atëherë oficer policie që të
25 gjeja kryerësit e veprës.

1 PY. Kur keni qenë në vendin e krimit duke kryer hetimet,
2 këqyrjet tuaja, juve nuk ju dha asnjë lloj informacioni që
3 kryerësit e veprës kanë qenë shqiptarë?

4 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kundërshtojmë. Pyetja mori
5 përgjigje dhe nuk ka relevancë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
7 përgjigjuni pyetjes.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Jo, nuk kam marrë asnjë
9 informacion.

10 Z. BAIESU: [Përkthim]

11 PY. Faleminderit. Kaq pyetje kisha për ju.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
13 juve.

14 A ka pyetje plotësuese?

15 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje plotësuese.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
17 Barthe, fjala për ju.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
19 Smith.

20 Pyetje nga Trupi Gjykses:

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Edhe mirëdita, z.
22 Schreckenbauer.

23 PË. Faleminderit shumë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit që jeni me ne
25 sot.

1 PË. E kam për nder dhe për detyrë që të jem këtu përpara
2 jush.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Megjithëse nuk kemi
4 përfunduar ende, dua t'ju them që kam disa pyetje, pak pyetje
5 për juve në emër të Trupit Gjykses lidhur me ngjarjet në
6 ndërtesën, ish-ndërtesën e MUP-it në Prizren më 18 qershor
7 1999.

8 Z. Schreckenbauer, atë ditën që është mësymur ndërtesa a
9 keni parë trupa serbë ju në afërsi të ndërtesës?

10 PË. Nuk kam vënë re asnjë trup serb në atë kohë. Të vetmet
11 trupa serbe që unë kam vënë re është ditën kur jemi kthyer në
12 Prizren, sepse atë ditë kur jemi kthyer në Prizren kishte
13 akoma forca serbe. Po më pas nuk kemi vënë re, nuk kam vënë re
14 trupa serbe.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund ta thoni për
16 procesverbal se kur ka qenë data kur keni hyrë në Prizren në
17 Kosovë?

18 PË. Nuk më kujtohet ekzaktësisht data, por ka qenë diku nga
19 data 12 deri më datën 14 qershor.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju nuk keni parë fare
21 forca serbe gjëkund tjetër në qytetin e Prizrenit ditën e
22 mësymjes në ndërtesën e MUP-it ose në ditën përpara, një ditë
23 përpara domethënë, më datë 17 qershor 1999?

24 PË. jo, gjatë asaj kohe nuk kam parë trupa të tillë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni ndonjë informacion

1 lidhur me kohën se kur mund të jenë larguar trupat serbe nga
2 Prizreni?

3 PË. Forcat e fundit serbe ishin ende aty por ishin thuar se në
4 rrugë e sipër për t'u larguar ditën që mbërritëm ne.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Dr.
6 Schreckenbauer. A keni vënë re ndonjë gjë të veçantë në
7 ndërtesën e MUP-it që tregonte që dikush e kishte përdorur
8 këtë ndërtesë ose kush e kishte përdorur këtë ndërtesë më datë
9 18 qershor pasdite?

10 PË. Jo.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
12 paraqesë provën P01997. Faleminderit.

13 Dr. Schreckenbauer, a e njihni këtë goditën, ndërtesën që
14 është fotografi?

15 PË. Është ndërtesa e MUP-it.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo fotografi a është bërë
17 ditën e mësymjes në ndërtesën e MUP-it më 18 qershor 1999?

18 PË. Nuk e di.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni pasur dijeni për
20 mësymje të tjera në këtë ndërtesë gjatë kohës kur keni
21 qëndruar në Kosovë?

22 PË. Jo, nuk e di. Nuk jam i informuar për rrethana të tilla
23 të ngjashme që kanë të bëjnë me këtë ndërtesë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dr. Schreckenbauer, a
25 shikoni diçka të ngjashëm me një flamur të kuq mbi hyrjen e

1 kësaj godine, ndërtese?

2 PË. Po, duket sikur është një flamur i kuq, megjithatë nuk e
3 shoh se çfarë është sipër tij, çfarë është në të.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet në qoftë se e
5 keni parë këtë flamur gjatë kohës kur keni qenë aty?

6 PË. Nuk më kujtohet.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kaq pyetje kisha për ju, Dr.
8 Schreckenbauer. Faleminderit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje të
10 tjera që rrjedhin nga pyetjet e Gjykatësi Barthe?

11 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Nuk kemi.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kemi.

13 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi.

14 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk kemi.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetje të
16 tjera shtesë nga ju, z. Baiesu?

17 Z. BAIESU: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
19 Dr. Schreckenbauer. Faleminderit që ishit me ne që dhatë
20 dëshmi përpara nesh. Megjithëse dëshmi e shkurtër,
21 informacioni që dhatë është i rëndësishëm për ne. Faleminderit
22 dhe ju urojmë gjithë të mirat.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit juve, të nderuar
24 Gjykatës.

25 [Dëshmitar largohet]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
2 tjetër për të thënë për Trupit Gjykses? Në qoftë se jo, do
3 takohemi përsëri në orën 9.00 të mëngjesit të hënën. Seanca
4 mbyllet këtu.

5 --- Seanca mbyllet në orën 15.21

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25